



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.145**

**2 nëntor**

**2007**

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM  
nr.686, datë 19.10.2007

Për miratimin e Marrëveshjes hidrokarbure, ndërmjet Albpetrol sh.a.-së dhe Sherwood International Petroleum LTD, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në vendburimin e Kuçovës .....

4023

**VENDIM**  
**Nr.686, datë 19.10.2007**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES HIDROKARBURE, NDËRMJET ALBPETROL  
SHA-SË DHE SHERWOOD INTERNATIONAL PETROLEUM LTD PËR ZHVILLIMIN  
DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE, NË VENDBURIMIN E KUÇOVËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Marrëveshjes hidrokarbure ndërmjet Albpetrol sh.a.-së dhe Sherwood International Petroleum Ltd për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokrabureve, në vendburimin e Kuçovës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**MARRËVESHJE HIDROKARBURE**  
**PËR ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË VENDBURIMIN, KUÇOVË**  
**DATË 24.9.2007**  
**NDËRMJET ALBPETROL SHA DHE SHERWOOD INTERNATIONAL PETROLEUM LTD**

Kjo Marrëveshje hidrokarbure e bërë dhe dorëzuar në Tiranë, Republikën e Shqipërisë më 4 shtator 2007

Ndërmjet

Albpetrol sh.a. një kompani shtetërore e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë (këtu dhe më poshtë referuar si “Albpetrol”)

nga njëra anë

dhe

Sherwood International, Ltd një kompani e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Alberta, Kanada dhe që ka degë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë (këtu dhe më poshtë referuar si “Kontraktor”) nga ana tjetër.

**Parathënie**

*ndërsa*, operacionet hidrokarbure në Republikën e Shqipërisë administrohen nga ligji hidrokarbur, nr.7746, datë 28.7.1993, siç është amenduar me ligjin nr.7853, datë 29.7.1994 dhe me ligjin nr.8297, datë 4.3.1998, së bashku të cituara si ligji hidrokarbur (kërkim dhe prodhim) 1993, nga dekreti nr.782, datë 22.2.1994 mbi sistemin fiskal në sektorin hidrokarbur (kërkim dhe prodhim), siç është amenduar me ligjin nr.7811, datë 12.4.1994 mbi aprovimin e dekretit nr.782 mbi sistemin fiskal në sektorin hidrokarbur (kërkim-prodhim), si dhe nga vendimi nr.547, datë 9.8.2006 mbi ngritjen e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (dokumentet ligjore të përmendura më parë referohen në mënyrë kolektive si “Ligji hidrokarbur”); dhe

*ndërsa*, në Republikën e Shqipërisë shteti është i vetmi pronar i të gjitha burimeve natyrore brenda territorit dhe zonave detare të saj dhe ka të drejtën për të kërkuar, zhvilluar, nxjerrë, prodhuar dhe përdorur burimet natyrore; dhe

*ndërsa*, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (këtu dhe më poshtë referuar si “AKBN”), në emër të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ka të drejtën ekskluzive për të hyrë në një licencëmarrëveshje me Albpetrolin, për të kryer të gjitha operacionet hidrokarbure të përshkruara

në këtë Marrëveshje; dhe

*ndërsa*, Albpetroli është palë në licencëmarrëveshjen e datës 7.6.2007; dhe

*ndërsa*, Kontraktori, Albpetroli dhe AKBN-ja kanë ekzekutuar instrumentin e transferimit, me kushtin që kjo Marrëveshje bëhet efektive; dhe

*ndërsa*, palët bëjnë këtë Marrëveshje për të regjistruar termat, mbi të cilën Kontraktori do t'i bashkohet Albpetrolit, për kryerjen e operacioneve hidrokarbure dhe bëhet palë në licencëmarrëveshjen e përmendur më sipër dhe për qëllime që lidhen me atë; dhe

*ndërsa*, Kontraktori ka kapacitet të mjaftueshëm kapital, teknik dhe komercial, kapacitet njerëzor dhe organizativ, të kërkuar për të përfunduar në mënyrë të suksesshme operacionet e specifikuar më poshtë; dhe

*ndërsa*, Kontraktori bie dakord të marrë përsipër detyrimet që parashikohen këtu dhe më poshtë, si një kontraktor, në lidhje me operacionet hidrokarbure, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje; dhe

*ndërsa*, secila nga Palët ka të drejtën, fuqinë dhe autoritetin për të hyrë në këtë Marrëveshje; dhe

*ndërsa*, Kontraktori dhe Albpetroli kanë si qëllim këtë Marrëveshje, për të regjistruar termat, mbi të cilën Kontraktori do të bashkohet me Albpetrolin, në kryerjen e operacioneve hidrokarbure dhe bëhet palë në licencëmarrëveshje dhe për qëllime që lidhen me atë, prandaj tani palët bien dakord këtu, si më poshtë:

## Neni 1 Definicionet

Në këtë Marrëveshje, fjalët në njëjës përmbajnë shumësin dhe anasjelltas dhe, përveç ku konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin që jepet si më poshtë:

1.1 “Abandonim” do të thotë abandonimi përfundimtar nëpërmjet çmontimit, heqjes dhe/ose asgjësimit të puseve dhe mjeteve të përdorura për operacione hidrokarbure dhe rehabilitimin e tokës rreth një pusi të abandonuar, në një kondicion jo më të keq se kondicioni i tij, sikurse në kohën, menjëherë para fillimit të operacioneve hidrokarbure, në lidhje me këtë pus ose pajisje dhe termi “të abandonosh” do të ketë kuptimin korrespondues.

1.2 “Kosto abandonimi” do të thotë kosto dhe shpenzime (pavarësisht të një natyre kapitale apo operacione) të kryera ose për t'u kryer, në lidhje me abandonimin e mjeteve ose pajisjeve.

1.3 “Plan abandonimi” do të thotë një plan i përgatitur nga Kontraktori ose ndonjë i projektuar nga dhe në emër të Kontraktorit për abandonimin e puseve, mjeteve dhe pajisjeve të përdorura për operacionet hidrokarbure.

1.4 “Procedurë llogaritëse” do të thotë procedurat dhe kërkesat e raportimit që jepen në aneksin B” të kësaj Marrëveshjeje, e cila formon një pjesë të integruar dhe të pandashme të saj.

1.5 “Filial” do të thotë një kompani ndihmëse, një kompani mëmë ose një kompani motër të një pale, ose një entitet që përbën një palë, për qëllime të definicioneve të përmendura më sipër:

a) një kompani ndihmëse është një kompani e kontrolluar nga një palë ose një entitet që përbën një palë;

b) një kompani mëmë është një kompani që kontrollon një palë ose një entitet që përbën një palë;

c) një kompani motër është një kompani që është kontrolluar ose i njëjti person si një palë ose entitet, që përfshin një palë.

“Kontroll” do të thotë që një person zotëron aksion themelor ose drejtpërdrejt, ose nëpërmjet personave të tjerë, i cili konfirmohet me një shumicë të votave në takimet e aksionarëve të kompanisë, i cili është kontrolluar.

1.6 “Marrëveshje” do të thotë kjo Marrëveshje hidrokarbure, së bashku me anekset siç mund të amendohet herë pas here, me rënie dakord të palëve dhe aprovim të Këshillit të Ministrave për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në zonën e kontratës.

1.7 “Zona e operacioneve të Albpetrolit” do të thotë ajo pjesë e zonës së kontratës, e cila është jashtë zonës së projektit.

1.8 “Pjesë e Albpetrolit” ka kuptimin e dhënë në nenin 9.2.

1.9 “Program vjetor” do të thotë një deklaram i specifikuar i operacioneve hidrokrabure, për

t'u kryer brenda ose në lidhje me zonën e projektit dhe afatet kohore të tij.

1.10 "Gaz shoqërues" do të thotë gaz natyror, i gjetur në bashkëshoqërim me naftën bruto, nëse kjo naftë bruto, mund të prodhohet vetë, në mënyrë komerciale.

1.11 "Naftë e disponueshme" do të thotë sasia e naftës (duke hequr çdo sasi të përdorur në operacionet hidrokarbure e djegur ose e injektuar dhe duke zbritur çdo prodhim të gjykuar, për të cilin Albpetroli është i titulluar, sipas kësaj Marrëveshjeje) e prodhuar, ruajtur dhe matur nga zona e projektit, në pikën e matjes.

1.12 "Barel" do të thotë një sasi me naftë bruto e barabartë me 158.987 litra në presion atmosferik standard prej 1.01325 bar dhe temperaturë prej gjashtëdhjetë gradë Fahrenheit (60°F).

1.13 "Studim bazë" ka kuptimin e dhënë në nenin 20.4.

1.14 "Buxhet" do të thotë një vlerësim i të ardhurës dhe shpenzimeve, në lidhje me një program vlerësimi ose një program vjetor.

1.15 "Tremujor kalendarik" do të thotë një periudhë prej tre (3) muajsh të vazhduar, duke filluar, më 1 janar, 1 prill, 1 korrik ose 1 tetor dhe duke përfunduar respektivisht, më 31 mars, 30 qershor, 30 shtator ose 31 dhjetor.

1.16 "Kondensat" do të thotë përzierje, kryesisht të përbëra nga pentan dhe hidrokarbur më të rëndë, të prodhuara drejtpërdrejt nga rezervuarët hidrokarbure ose të fituara nga kondensimi i gazit, të cilët janë lëngje në kushte normale të ambientit të temperaturës dhe presionit atmosferik.

1.17 "Kontraktor" do të thotë kontraktor dhe pasardhësit e tij respektiv ose marrësit e lejuar të interesave, sipas nenit 16.

1.18 "Të ardhura të Kontraktorit" do të thotë të ardhurat në para të marra nga Kontraktori, si rezultat i shitjes së naftës për mbulim kosto dhe naftës fitim, siç përshkruhet në mënyrë më të plotë në procedurën llogaritëse.

1.19 "Zonë kontrate" do të thotë sipërfaqja gjeografike në Shqipëri, e cila në mënyrë më specifike (në mënyrë horizontale dhe vertikale) jepet në aneksin A.

1.20 "Vit kontraktual" do të thotë një periudhë prej një vit duke filluar me datën efektive ose ndonjë përvjetor të datës efektive.

1.21 "Llogaria kosto" do të thotë një komplet i llogarive të mbajtura nga Kontraktori, në përputhje me klauzolat e procedurës llogaritëse, duke treguar pagesat, kreditimet dhe transaksionet e tjera të kryera në lidhje me operacionet hidrokarbure.

1.22 "Naftë për mbulim kosto" ka kuptimin e dhënë në nenin 9.2.

1.23 "Mbulim kosto" ka kuptimin e dhënë në nenin 9.3.

1.24 "Naftë bruto" ka të njëjtin kuptim që jepet për këtë term në ligjin hidrokarbur.

1.25 "Prodhim i gjykuar" ka kuptimin e dhënë në nenin 3.5.1.

1.26 "Pikë livrimi" do të thotë pikat e mëposhtme, të rëna dakord nga palët dhe aprovuar nga AKBN-ja ose çdo pikë tjetër e rënë dakord ndërmjet palëve dhe e aprovuar nga AKBN-ja:

1.26.1 në të cilën nafta bruto merret nga Kontraktori, për shitje për eksport, FOB portin shqiptar përkatës;

1.26.2 në të cilën nafta bruto merret nga Kontraktori, për shitje tek ARMO ose ndryshe (por jo për shitje për eksport) në pikën e livrimit, sipas asaj kontrate të shitjes së naftës bruto; dhe

1.26.3 në të cilën nafta bruto livrohet tek Albpetroli, në përputhje me nenin 3.5 ose nenin 9 në pikën që përcaktohet me marrëveshje midis Albpetrolit dhe Kontraktorit.

1.27 "Zonë zhvillimi dhe prodhimi" do të thotë sipërfaqja, siç përcaktohet në planin e zhvillimit, në përputhje me nenin 7.2.1 ose një plan zhvillimi të rishikuar. Sapo të jetë përcaktuar, zona e zhvillimit dhe e prodhimit, do të shtrihet në të gjitha thellësitë brenda kufijve anësorë të tij.

1.28 "Periudhë zhvillimi dhe prodhimi" do të thotë, në lidhje me zonën e zhvillimit dhe prodhimit, periudha e specifikuar në nenin 3.

1.29 Plan zhvillimi do të thotë një plan për punime, aktivitete përkatëse dhe buxhete që japin strategjinë e përgjithshme për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokrabureve, nga zona e projektit i përgatitur nga Kontraktori dhe aprovuar në përputhje me nenin 7, duke përfshirë çdo amendim të tij.

1.30 "Datë efektive" do të thotë data në të cilën, në përputhje me ligjin hidrokarbure, Këshilli i Ministrave lëshon një vendim, duke aprovuar këtë Marrëveshje.

1.31 "Mjedis" do të thotë përbërësit e tokës, dhe përfshijnë:

1.31.1 ajër, tokë dhe ujë;

1.31.2 të gjitha shtesat e atmosferës;

1.31.3 të gjithë lëndën organike dhe inorganike dhe organizmat e gjalla; dhe

1.31.4 sistemet natyrale ndërvepruese që përfshijnë komponentët që referohen në seksionet 1.31.1 deri 1.31.3.

1.32 “Dëmtime të mjedisit” do të thotë ndotje dhe të gjitha humbjet, plagosjet, vdekjet, dëmtimet ose ngjarje të tjera të çfarëdo llojeve, dhe sidoqoftë ose kurdo qoftë që ndodh, në ose në lidhje me mjedisin (duke përfshirë, por pa u kufizuar në çdo humbje ose dëmtim të pasurisë reale ose personale) në lidhje me të cilën, çdo përgjegjësi ose detyrim, ka lindur ose mund të ndodhë në të ardhme ndaj Kontraktorit, filialeve të tij çdo pasardhësi të Kontraktorit ose filialeve të tij ose nëndegëve, ose secilit prej tyre, për të kryer çdo rregullim, bonifikim, pastrim ose shpenzime të tjera, ose të kompensojë ndonjë person ose pasuri të ndonjë personi, pavarësisht për arsye të ndonjë përgjegjësie të drejtë, ligji të zakonshëm, të përcaktuar me ligj ose përgjegjësie civile, ose detyrimi, ose rregullimi të zakonshëm, pavarësisht nëse i aplikueshëm për shkak të pronësisë ndaj zonës së kontratës ose përgjegjësitë për çdo operacion të kryer në, ose në lidhje me atë, në çdo kohë në të shkuar, të tashme ose të ardhme dhe pavarësisht, nëse ndodh nga neglizhenca ndonjë gjë e papëlqyer ose ndryshe, humbje, plagosje ose dëmtim, i cili do të përfshijë, por pa u kufizuar në të gjitha dëmtimet, shpërblimet, shpenzimet dhe kostot (duke përfshirë kostot legale mbi një bazë avokati dhe klientit të vet) të kryera në çfarëdo mënyre, në lidhje me çështje të tilla.

1.33 “Zonë vlerësimi” do të thotë sipërfaqja 150 m veri, lindje, jug, perëndim të qendëruar në çdo pus vlerësimi. Kjo sipërfaqe nuk duhet të interferohet me operacionet e puseve fqinje.

1.34 “Periudhë vlerësimi” do të thotë periudha, gjatë të cilës Kontraktori do të zbatojë programin e vlerësimit, periudhë e cila është përshkruar në nenin 3.2.

1.35 “Program vlerësimi” do të thotë një program i punës për t’u kryer nga Kontraktori, siç specifikohet në aneksin D.

1.36 “Pus vlerësimi” do të thotë pus, në lidhje me të cilin, do të kryhet aktivitetet gjatë programit të vlerësimit.

1.37 “Studim bazë” do të thotë survejim i plotë i gjendjes së ambientit, për rehabilitim të vendburimit, Kuçovë, Shqipëri nga Kontraktori.

1.38 “Ekspert” do të thotë një individ ose një person, i cili nuk është banor ose qytetar i Shqipërisë dhe nuk ka qenë i punësuar nga Kontraktori, Albpetroli ose AKBN-ja dhe i cili nga kualifikimi dhe eksperiencia e gjerë, ka njohuri shumë të larta të fushës teknike në të cilën shtrihet kundërshtimi ose mosmarrëveshja, në të cilën ai ose ajo, do ta zgjidhë, dhe që është caktuar në përputhje me klauzolën e nenit 19.10.

1.39 “Vit fiskal” do të thotë periudha prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm të kalendarit Gregorian duke filluar, më 1 janar dhe duke përfunduar, më 31 dhjetor, të dyja datat përfshirë.

1.40 “Metoda IOR/EOR” do të thotë operacionet hidrokarbure, të cilat synojnë për të arritur efektivitetin maksimal të nxjerrjes nga rezervuari, nëpërmjet përmirësimit të sistemit të tij energjetik natyral dhe drenimit të hidrokarbureve të tij duke aplikuar, por pa u kufizuar në rikompletimin, ripunimin, metodat e ftohta të nxjerrjes së naftave të rënda, metodat e drenazhimit me gravitet të ndihmuara me avull, injektimi i ujit, ripresimi, ngrohja termike, shpimi vertikal dhe horizontal, dhe metoda të tjera të nxjerrjes së përshpejtuar.

1.41 “Licencëmarrëveshje” do të thotë licencëmarrëveshja e datës 7.6.2007 dhënë nga Ministria dhe AKBN-ja për Albpetrolin, për të drejtuar operacionet hidrokarbure në zonën e kontratës, dhe në të cilën Kontraktori do të bëhet palë me ekzekutimin dhe regjistrimin e instrumentit të transferimit bashkëngjitur si aneks E.

1.42 “I licencuar” do të thotë së bashku Albpetroli, i cili është një palë në licencëmarrëveshje dhe Kontraktori, i cili do të bëhet palë e licencëmarrëveshjes, sapo të ekzekutohet dhe regjistrohet instrumenti i transferimit, bashkëngjitur si aneks E.

1.43 “Humbjet dhe përgjegjësi” do të thotë, në lidhje me një palë, të gjitha humbjet, kostot, dëmtimet dhe shpenzimet, të cilat kjo palë vuan, pëson ose kryen duke përfshirë, por pa u kufizuar, në pagesat ligjore dhe pagesat mbi një bazë avokati dhe klientit të vet.

1.44 “Pikë matjeje” do të thotë një pikë e tillë e përcaktuar nga AKBN-ja dhe palët, ku pajisjet dhe mjetet e përshtatshme do të vendosen për qëllim të kryerjes së matjeve volumetrike dhe përcaktimeve të tjera, temperaturës dhe rregullimeve të tjera, përcaktimin e ujit dhe mbetjes mekanike dhe matjeve të tjera, siç duhet për të përcaktuar, për qëllime të ndryshme të licencëmarrëveshjes dhe kësaj Marrëveshjeje, volumet e naftës. Pika e matjes mund të jetë ose të mos jetë e njëjta pikë me

pikën e livrimit.

1.45 “Ministri” do të thotë ministria e ngarkuar për aktivitetin hidrokarbur në Republikën e Shqipërisë.

1.46 “Gaz natyror” do të thotë çdo hidrokarbur ose përzierje e hidrokarbureve, e përbërë kryesisht prej metani, në një gjendje të gazit, në kushte normale të presionit dhe temperaturës e prodhuar nga nëntoka veçmas ose së bashku me hidrokarburet e lëngëta.

1.47 “Zonë e re vlerësimi” ka kuptimin e dhënë në nenin 3.4.6.

1.48 “Program i ri vlerësimi” ka kuptimin e dhënë në nenin 3.4.6.

1.49 “AKBN” do të thotë Agjencia e ngritur nga Qeveria e Shqipërisë, përgjegjëse për zbatimin e ligjit hidrokarbur, siç përcaktohet në vendimin nr.547, datë 9.8.2006, nga Këshilli i Ministrave.

1.50 “Operator” do të thotë Kontraktor ose, nëse Kontraktori përbëhet nga më shumë se një person, ky person i caktuar siç duhet nga palët, për kryerjen dhe zbatimin e operacioneve hidrokarbure në emër të, për llogari të, dhe sipas përgjegjësisë së Kontraktorit.

1.51 “Palë” ose “Palët” do të thotë Albpetrol ose Kontraktor, ose të dy.

1.52 “Person” do të thotë çdo individ, korporatë, partnership, joint venture, shoqatë, kompani aksionare, trust, kompani e painkorporuar, autoritet qeveritar shqiptar ose formë tjetër entiteti.

1.53 “Hidrokarbur” do të thotë naftën bruto, kondensat ose gaz natyror.

1.54 “Operacione hidrokarbure” do të thotë të gjitha ose ndonjë prej operacioneve, duke përfshirë abandonimin e synuar ose autorizuar nga licencëmarrëveshja dhe operuar nga palët në ose, pas datës efektive, duke përfshirë pa kufizim testimin, zhvillimin, nxjerrjen, prodhimin, trajtimin, transportimin dhe grumbullimin e naftës prej ose nga zona e kontratës në përputhje me licencëmarrëveshjen dhe këtë Marrëveshje hidrokarbure.

1.55 “Kosto hidrokarbure” do të thotë të gjitha kostot dhe shpenzimet e mbartura, dhe të kryera nga Kontraktori, në ose në lidhje, me kryerjen e operacioneve hidrokarbure, në përputhje me këtë Marrëveshje, të përcaktuara dhe shpjeguara në përputhje me procedurën llogaritëse, por nuk përfshin taksat.

1.56 “Zonë projekti” do të thotë:

1.56.1 gjatë periudhës së vlerësimit, ajo pjesë e zonës së kontratës, e cila përcaktohet herë pas here si zonë vlerësimi;

1.56.2 gjatë periudhës së zhvillimit dhe prodhimit, ajo pjesë e zonës së kontratës, e cila përcaktohet herë pas here, si zonë zhvillimi dhe prodhimi; dhe

1.56.3 nëse Kontraktori ndërmerr një program vlerësimi të ri, ajo pjesë e zonës së kontratës, e cila përcaktohet herë pas here, si zona e re e vlerësimit.

1.57 “Naftë fitim” ka kuptimin e dhënë në nenin 9.4.

1.58 “Taksa dhe detyrime doganore” do të thotë të gjitha taksat, detyrimet doganore, tarifata, shpërblimet dhe pagesat e tjera, të çdo natyre, të pagueshme ndaj Qeverisë së Shqipërisë (ose të ndonjë prej agjencive të saj) ose të ndonjë prej nënndarjeve të saj politike ose administrative (ose agjencive).

1.59 “US \$” ose “Dollar US” do të thotë dollar i Shteteve të Bashkuara, që është monedha legale e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

## Neni 2

### **Qëllimi i Marrëveshjes, anekset e Marrëveshjes**

2.1 Kjo Marrëveshje është një rënie dakord për operacione vlerësimi, zhvillimi dhe prodhimi dhe ajo do të mbulojë operacionet hidrokarbure, në zonën e kontratës. Të drejtat, dhe detyrimet e palëve, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të kenë fuqi duke filluar nga data efektive. Albpetroli do të njoftojë Kontraktorin për datën e aprovimit nga Këshilli i Ministrave brenda pesë (5) ditë pune nga data e kryerjes së saj.

2.2 Në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe nenet 2.3 dhe 2.4, Albpetroli këtu, në mënyrë të përvokueshme cakton dhe konstituon Kontraktorin në mënyrë të vetme dhe ekskluzive, për të kryer operacionet hidrokarbure në zonën e projektit, gjatë periudhës së specifikuar këtu dhe të zgjerohet zonën e projektit, në përputhje me këtë Marrëveshje, për të përfshirë çdo pjesë toke brenda zonës së kontratës.

2.3 Në përputhje me seksionin 3.2 të licencëmarrëveshjes, palët kanë të drejtë ekskluzive:

- a) të kryejnë operacione hidrokarbure në zonën e kontratës;
- b) të trajtojnë, grumbullojnë dhe transportojnë naftën e prodhuar nga zona e kontratës;
- c) të ndërtojnë dhe instalojnë të gjitha mjetet dhe pajisjet (duke përfshirë grumbullimin, trajtimin, tubacionet dhe mjetet e tjera të transportit) të kërkuara për operacionet hidrokarbure; dhe
- d) ta përdorin për llogari të vet, ta shesin, shkëmbejnë, eksportojnë, ta nxjerrin ose posedojnë naftën e prodhuar nga zona e kontratës dhe të marrin fitim nga, dhe të titullohen ndaj kësaj nafte të prodhuar, përveç rasteve kur i nënshtrohen të drejtës së porosisë, në kushte emergjence për të furnizuar ose të kontribuojë për të furnizuar tregun lokal.

Në përputhje me seksionin 3.2 të licencëmarrëveshjes dhe pavarësisht nenit 2.3 (a), (b), (c) dhe (d) çdo kontraktor tjetër mund të kryejë operacione hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e naftës, jashtë zonës së kontratës, në përputhje me çdo marrëveshje të arritur ndërmjet një kontraktori dhe AKBN-së. Ministria, Albpetroli, AKBN-ja dhe Kontraktori do të sigurojnë, që operacionet hidrokarbure, nuk do të përzihen dhe pengojnë në mënyrë të paarsyeshme zhvillimin normal të operacioneve hidrokarbure të Kontraktorit, në zonën e kontratës dhe që as Kontraktori nuk do të pengojë ose përzihet, me operacionet hidrokarbure të këtij kontraktori tjetër.

2.4 Albpetroli ka të drejtën të kryejë operacione hidrokarbure për llogari të vet, në ndonjë pjesë të zonës së kontratës, e cila nuk është përcaktuar si zona e projektit, deri në atë kohë, sapo Kontraktori t'i kërkojë Albpetrolit të ndërpresë këto operacione. Çdo pjesë e zonës së kontratës mund të zgjidhet nga Kontraktori për t'u bërë zonë vlerësimi, një zonë e re vlerësimi ose zona e zhvillimit dhe prodhimit, në përputhje me këtë Marrëveshje (aneksi F) pavarësisht nëse Albpetroli është duke kryer operacione hidrokarbure në këtë zonë.

2.5 Kontraktori do të jetë përgjegjës për kryerjen e operacioneve hidrokarbure vetëm në zonën e projektit, në përputhje me klauzolat e kësaj Marrëveshjeje, veçmas nga operacionet hidrokarbure të kryera nga Albpetroli vetëm në zonën e operacioneve të Albpetrolit, nëse ka ndonjë. Në përputhje me këtë, të drejtat, interesat, detyrimet, përgjegjësit dhe zhdëmtimet e palëve në zonën e kontratës, do të alokohen si më poshtë:

Pala	Interesi në zonën e projektit	Interesi në zonën e operacioneve të Albpetrolit
Albpetroli	0%	100%
Kontraktori	100%	0 %

Pa paragjykuar pozicionin e Kontraktorit, si një kontraktor këtu, dhe më poshtë, masa dhe karakteri i punës, që do të bëhet nga Kontraktori, do të jetë subjekt i rishikimit dhe aprovimit të Albpetrolit, në masën e dhënë në këtë Marrëveshje. Pavarësisht të ndonjë gjëje në kundërshtim me licencëmarrëveshjen ose këtë Marrëveshje;

2.5.1 Secila nga palët është përgjegjëse, veçmas dhe jo bashkërisht, për të drejtat, interesat, detyrimet, përgjegjësitë dhe zhdëmtimet e të licencuarit, siç jepet në këtë Marrëveshje; dhe

2.5.2 Kontraktori do të jetë përgjegjës, sipas licencëmarrëveshjes dhe kësaj Marrëveshjeje, veçmas për operacionet hidrokarbure të kryera në zonën e projektit dhe jo në vend tjetër, dhe Albpetroli do të jetë përgjegjës, sipas licencëmarrëveshjes dhe kësaj Marrëveshjeje, veçmas për operacionet hidrokarbure të kryera në zonën e operacioneve të Albpetrolit dhe jo në vend tjetër, duke përfshirë pa kufizim:

2.5.2.1 detyrimet që kanë të bëjnë me abandonimin;

2.5.2.2 pagimin e kostove dhe shpenzimeve të operacioneve hidrokarbure;

2.5.2.3 zhdëmtimet;

2.5.2.4 përgatitjen e planit të zhvillimit dhe programeve vjetore dhe buxheteve;

2.5.2.5 llogaritjen dhe pagesën e taksës mbi naftën fitim;

2.5.2.6 përputhshmërinë me standardet operacionale dhe të mjedisit;

2.5.2.7 përgatitjen e studimeve të nivelit bazë;

2.5.2.8 përgatitjen e librave të llogarive, regjistrimeve dhe llogarive të kostove hidrokarbure, naftës për mbulim të kostove dhe të ardhurave;

2.5.2.9 forcës madhore dhe përfundimit të forcës madhore; dhe

2.5.2.10 klauzolave të prishjes dhe mbylljes.

Kontraktori do të zhdëmtojë Albpetrolin, filialet e tij, drejtorët, nëpunësit, punonjësit dhe

agjentët nga dhe kundrejt çdo humbjeje dhe detyrimi që lind nga çdo shkelje nga Kontraktori i këtij neni 2.5.2 dhe Albpetroli do të zhdëmtojë Kontraktorin, filialet e tij, drejtorët, nëpunësit, punonjësit dhe agjentët nga dhe kundrejt çdo humbjeje dhe detyrimi që lind nga çdo shkelje nga Albpetroli i këtij neni 2.5.2.

2.5.2 Palët bien dakord që:

2.5.3.1 çdo hipotekim i dhënë nga pala, mund të aplikohet, vetëm në lidhje me interesin e saj në zonën e kontratës; dhe

2.5.3.2 të drejtat e përdorimit lirshëm të naftës së prodhuar nga zona e kontratës, për operacione hidrokarbure aplikohet vetëm ndaj naftës së prodhuar nga dhe operacionet hidrokarbure të kryera, në lidhje me interesat respektive të palëve në zonën e kontratës.

2.6 Për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, Kontraktori do të sigurojë të gjitha kërkesat teknike dhe financiare, dhe do të përdorë metoda, procedura, teknologji dhe pajisje përgjithësisht të pranuar në industrinë ndërkombëtare të naftës, të cilat respektojnë rregullat e ruajtjes së mjedisit, punonjësve dhe karakteristikat e rezervuarit.

2.7 Kontraktori do të kryejë operacione hidrokarbure këtu dhe më poshtë me kosto dhe riskun e vet, po qe se në këtë Marrëveshje nuk jepet shprehimisht ndryshe.

2.8 Po qe se nuk deklarohet ndryshe, siç jepet këtu ose bihet dakord ndryshe, me shkrim, Kontraktori nuk do të marrë as kompensim për shërbimet e tij, as edhe ndonjë rimbursim të shpenzimeve, sipas kësaj Marrëveshjeje, përveçse për pjesën e naftës nga zona e projektit, për të cilën do të titullohet sipas nenit 9.

2.9 Gjatë afatit të kësaj Marrëveshjeje e gjithë nafta e prodhuar nga zona e vlerësimit dhe ndonjë zonë zhvillimi dhe prodhimi do të ndahet ndërmjet Albpetrolit dhe Kontraktorit, në përputhje me klauzolat këtu.

2.10 Kjo Marrëveshje nuk i jep Kontraktorit të drejtën e pronësisë ndaj hidrokarbureve në shtresë në zonën e projektit. Sidoqoftë, Kontraktori do të ketë të drejtën të marrë në natyrë, disponojë dhe eksportojë lirshëm pjesën e tij të naftës nga zona e projektit, në përputhje me klauzolat e kësaj Marrëveshjeje. Kontraktori do të bëhet palë në licencëmarrëveshje, me nënshkrimin e instrumentit të transferit, i cili është nënshkruar nga Albpetroli dhe Kontraktori, në të njëjtën kohë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje.

2.11 Anekset A, B, C, D, E dhe F, në këtë Marrëveshje, bëhen këtu pjesë e kësaj Marrëveshjeje dhe ato do të konsiderohen që kanë të njëjtën fuqi dhe efekt me klauzolat e kësaj Marrëveshjeje. Pavarësisht kësaj, në rast të ndonjë konflikti ndërmjet anekseve dhe pjesës kryesore të kësaj Marrëveshjeje, pjesa kryesore e kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojë.

### Neni 3 Kohëzgjatja

3.1 Po qe se nuk mbyllet më shpejt, në përputhje me termat këtu, kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi gjatë periudhës së vlerësimit dhe ndonjë periudhe zhvillimi dhe prodhimi.

3.2 Periudha e vlerësimit fillon në datën efektive dhe vazhdon deri ditën e fundit të muajit, e cila është 24 muaj duke përfshirë një periudhë prej gjashtë (6) muajsh që Albpetroli t'i japë Kontraktorit të gjitha të dhënat e nevojshme për vendburimin e Kuçovës dhe një periudhë prej 18 muajsh për zbatimin e programit të punës nga Kontraktori. Kontraktori do të kryejë programin e vlerësimit gjatë periudhës së vlerësimit. Nëse Kontraktori dhe Albpetroli kanë mendimin që një periudhë më e gjatë kërkohet për të përfunduar periudhën e vlerësimit ose për të vlerësuar rezultatet e aktiviteteve dhe metodave IOR/EOR, të kryera në programin e vlerësimit, atëherë me kërkesë me shkrim dhe aprovim të AKBN-së, e cila duhet të dorëzohet të paktën dyzet e pesë (45) ditë para përfundimit të periudhës së vlerësimit, kjo periudhë vlerësimi do të zgjatet për një periudhë tjetër, deri në gjashtë muaj.

3.3 Kontraktori mund të zgjedhë për të mbyllur këtë Marrëveshje, me përfundimin e periudhës së vlerësimit, duke njoftuar me shkrim Albpetrolin, shoqëruar me një kopje tek AKBN-ja. Nëse Kontraktori përfundon këtë Marrëveshje, më mënyrë të tillë, të gjitha pusët, operacionet, asetet (të lëvizshme apo të palëvizshme) do të kthehen tek AKBN-ja ose i përcaktuari i saj dhe Kontraktori do të çlirohet nga të gjitha përgjegjësitë, që lidhen me këtë Marrëveshje.

3.4 Plani i zhvillimit



3.4.1 Në çdo kohë, para përfundimit të periudhës së vlerësimit, Kontraktori mund të propozojë një zonë zhvillimi dhe prodhimi për: (i) zonën e vlerësimit; dhe (ii) pjesë tjetër të tillë të zonës së kontratës, të cilën, në bazë të eksperiencës, gjatë programit të vlerësimit, Kontraktori e gjykon që mund të jetë e përshtatshme, për operacione hidrokarbure ekonomike. Kontraktori do të dorëzojë një plan zhvillimi për zonën e zhvillimit dhe prodhimit. Plani i zhvillimit dhe prodhimit do të përgatitet mbi bazën e principeve inxhinierike dhe ekonomike më me zë dhe në përputhje me praktikën, përgjithësisht të pranuar të industrisë ndërkombëtare të naftës.

3.4.2 Plani i zhvillimit do të paraqitet për aprovim tek AKBN-ja. AKBN-ja mund të kërkojë ndryshime të planit të zhvillimit dhe Kontraktori mund të amendojë planin e zhvillimit në përgjigje të një kërkesë të tillë, me aprovim të palëve.

3.4.3 Nëse AKBN-ja nuk e aprovon planin e zhvillimit, pavarësisht se ai reflekton principet inxhinierike dhe ekonomike bashkëkohore të praktikave të industrisë ndërkombëtare të naftës, secila prej palëve mund të paraqesë konfliktin për përcaktim të ekspertit, në përputhje me klauzolat e licencëmarrëveshjes.

3.4.4 Gjatë periudhës, në të cilën plani i zhvillimit është në pritje për aprovim nga AKBN-ja ose është duke u rishikuar nga Kontraktori, në përgjigje të kërkesave të AKBN-së, Kontraktori mund të vazhdojë operacionet në zonën e vlerësimit dhe zonën e zhvillimit dhe prodhimit të propozuar, të ngjashme me ato të kryera gjatë programit të vlerësimit, me kusht që Kontraktorit nuk i kërkohet të kryejë ndonjë shpenzim kapital, mbi shumën prej një milion e gjysmë (1 500 000 \$US) shpenzime kapitale, si angazhim, sipas periudhës së vlerësimit.

3.4.5 Në çdo kohë gjatë zbatimit të planit të zhvillimit, Kontraktori mund të propozojë një rishikim të planit të zhvillimit. Këto rishikime mund të përfshijnë një zgjerim të zonës së zhvillimit dhe prodhimit, për të përfshirë sipërfaqe në kontakt me ndonjë pjesë ekzistuese të zonës së zhvillimit dhe prodhimit, për t'u vlerësuar herë pas here, nëpërmjet metodave IOR/EOR, të cilat Kontraktori i propozon për t'u ndërmarrë, sipas rishikimit të propozuar të planit të zhvillimit, në përputhje me kufizimin që zona e zhvillimit dhe prodhimit nuk mund të zgjerohet më tej, pa miratimin e Albpetrolit dhe AKBN-së, pas përvjetorit të pestë të aprovimit fillestar të planit të zhvillimit. Çdo rishikim ndaj planit të zhvillimit, do të përgatitet mbi bazën e principeve inxhinierike dhe ekonomike më me zë dhe në përputhje me praktikën, përgjithësisht të pranuar, të industrisë ndërkombëtare të naftës, dhe do të ndjekë një proces aprovimi të njëjtë me ato të planit të zhvillimit fillestar.

3.4.6 Gjatë zbatimit të planit të zhvillimit, Kontraktori mund të propozojë dhe projektojë për aprovim nga Komiteti këshillimor sipërfaqe të reja vlerësimi, brenda zonës së kontratës, por jashtë çdo zone zhvillimi dhe prodhimi të propozuar për një periudhë vlerësimi të re, në përputhje me kufizimin që zona e projektit nuk mund të zgjerohet më tej, pa miratimin e Albpetrolit dhe AKBN-së, pas përvjetorit të pestë të aprovimit fillestar të planit të zhvillimit. Me aprovim të AKBN-së aprovim, i cili nuk do të kundërshtohet në mënyrë të paarsyeshme, kjo periudhë vlerësimi e re do të ketë një afat fillestar prej 24 muajsh nga fillimi, e cila do të përfshijë 6 muajt e fillimit për të mbledhur të dhënat e nevojshme për vendburimin e Kuçovës dhe një vazhdim prej 18 muajsh për të kryer programin e punës dhe do të përfshijë programin përkatës të vlerësimit "Programi i ri i vlerësimit", me vlerësim të Kontraktorit. Programi i ri i vlerësimit do të shtohet tek aneksi D. Zona e re e vlerësimit mund të përfshijë sipërfaqe brenda zonës së kontratës, ku mund të kryhen aktivitete të reja vlerësimi, dhe në vazhdimësi zhvillimi dhe prodhimi. Pas përfundimit të secilës periudhë vlerësimi të re duhet dorëzuar një ndryshim i planit të zhvillimit ose të hiqet dorë nga sipërfaqja e re e vlerësimit.

3.4.7 Gjatë periudhës së re të vlerësimit, Kontraktori do të kryejë programe pune minimale dhe angazhime për shpenzime kapitale, siç përshkruhet dhe detajohet në programin e ri të vlerësimit dhe shtuar në aneksin D, sidoqoftë me kushtin që, nëse në përfundim të periudhës së re të vlerësimit ose ndonjë zgjatje të saj, ose me mbylljen e kësaj licencëmarrëveshjeje cilado qoftë që ndodh e para, Kontraktori ka dështuar të kryejë në përputhje me këtë Marrëveshje, në total ose pjesërisht, programin minimal të punës, dhe angazhimit të shpenzimeve kapitale, siç i shtohen aneksit D, atëherë Kontraktori do t'i paguajë AKBN-së një sasi të barabartë me pjesën e paplotësuar të angazhimit minimal të shpenzimeve kapitale, siç është shtuar në aneksin D.

3.5 Në zbatim të programit të vlerësimit, planit të zhvillimit dhe çdo programi vlerësimi të ri, Kontraktorit do t'i jepet e drejta të marrë çdo pus ekzistues, aset dhe sipërfaqe toke në zonën e projektit, pa kompensim, atje ku Albpetrolit është i titulluar për puse, asete dhe sipërfaqe toke të tilla, me kushtin çka jepet në këtë klauzolë.

3.5.1 Çdo pus i Albpetrolit në zonën e kontratës mund të merret në dorëzim nga Kontraktori, në përputhje me procedurën e marrjes në dorëzim të përshkruar në aneksin F. Prodhimi i gjykuar do të llogaritet si më poshtë: Për puset që do të merren nga Kontraktori, prodhimi i gjykuar do të jetë 80% e mesatares së prodhimit të naftës bruto, për 6 muaj para datës në të cilën pusi është marrë nga Kontraktori, për qëllime operationale, dhe duke aplikuar më pas një rënie vjetore prej dhjetë për qind (10%) ndaj prodhimit të gjykuar.

3.5.2 Kur Kontraktori merr në dorëzim ndonjë pus ekzistues, aset ose sipërfaqe toke dhe Albpetroli nuk është i titulluar për këto, Kontraktori do të jetë përgjegjës për kompensim ndaj palëve të treta, për të marrë këto të drejta.

3.6 Pa kufizuar të drejtat e palëve sipas nenit 12, në rast se Kontraktori ndalohet, ose pengohet për kryerjen e operationeve hidrokarbure ose për të hyrë në zonën e kontratës, për arsye që lidhen me mbrojtjen e personelit, nënkontraktorëve ose pasurisë, ose për probleme të importimit të pajisjeve dhe jashtë kontrollit të Kontraktorit, detyrimet e Kontraktorit, këtu dhe më poshtë, do të pezullohen nga koha e fillimit të këtij dëmtimi, derisa ky dëmtim të jetë zbutur. Pas kësaj, por sa më shpejt të jetë e mundur, palët do të takohen dhe bien dakord për një periudhë kohe, e cila duhet shtuar në periudhën e vlerësimit, dhe çdo periudhë zhvillimi dhe prodhimi, periudhë kohe, e cila duhet të jetë e barabartë me periudhën e kohës së nevojshme për të rivendosur operationet hidrokarbure në gjendjen, në të cilën ato ishin në kohën e dëmtimit.

3.7 Kontraktori mund të zgjedhë të mbyllë këtë Marrëveshje, në çdo kohë të periudhës së zhvillimit dhe prodhimit duke njoftuar AKBN-në me shkrim. Mbyllja do marrë efekt nëntëdhjetë (90) ditë pas dorëzimit të njoftimit. Nëse Kontraktori mbyll këtë Marrëveshje në mënyrë të tillë, të gjitha puset, operationet dhe asetet (e tundshme dhe të patundshme) do të kthehen tek AKBN-ja dhe Kontraktori do të çlirohet nga të gjitha përgjegjësitë në lidhje me këtë Marrëveshje, përveç detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, të cilat janë vendosur para mbylljes, duke përfshirë pa kufizim ndonjë detyrim për mjedisin dhe abandonimin, sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe licencëmarrëveshjeje. Nëse Kontraktori anulon, ose dorëzon Marrëveshjen hidrokarbure, gjatë një viti kalendarik të periudhës së zhvillimit dhe prodhimit, në të cilin aplikohet një program vjetor dhe buxhet i aprovuar, Kontraktori do t'i paguajë AKBN-së shumën e çdo shpenzimi kapital të pashpenzuar, që jepet sipas programit vjetor dhe buxhetit për atë vit fiskal.

3.8 Periudha e zhvillimit dhe prodhimit do të fillojë në datën që plani i zhvillimit do të aprovohet nga Albpetroli dhe AKBN-ja dhe do të vazhdojë deri në përfundim të vitit të 25 (njëzet e pesë) nga data e aprovimit të planit. Me përfundimin e periudhës së zhvillimit, dhe prodhimit, palët kanë të drejtë, që në përputhje me licencëmarrëveshjen, të kërkojë nga AKBN-ja një zgjatje të periudhës së zhvillimit dhe prodhimit për një periudhë prej pesë (5) vitesh suksesive, me të njëjtat kushte siç jepet këtu.

#### Neni 4 **Heqjet dorë**

4.1 Kontraktori mund të heqë dorë vullnetarisht, në çdo kohë nga të drejtat e tij këtu dhe më poshtë për të kryer operatione hidrokarbure në të gjitha ose çdo pjesë të zonës së kontratës. Asnjë heqje dore nuk do ta çlirojë Kontraktorin nga angazhimet e tij minimale të paplotësuara për një program vlerësimi, dhe çdo program vjetor dhe buxhet sipas nenit 3.7 dhe nenit 6.1.

4.2 Të paktën tridhjetë ditë (30) ditë para datës së një heqjeje dore sipas nenit 4.1, palët do të njoftojnë AKBN-në, për pjesën e zonës së Kontratës, nga e cila do të hiqet dorë.

4.3 Në datën që ndonjë heqje dorë është efektive, me aprovim të AKBN-së ose në mbyllje të kësaj Marrëveshjeje, Kontraktori nuk do të ketë të drejta ose detyrime të tjera, në lidhje me sipërfaqen nga e cila është hequr dorë.

4.4 Pranohet që, si rezultat i heqjeve dorë, në përputhje me këtë nen 4, zona e zhvillimit dhe prodhimit, mund të përbëhet prej më shumë se një sipërfaqeje, jo të vazhduara.

#### Neni 5 **Drejtimi i operationeve**

##### 5.1 Komiteti këshillimor

5.1.1 Për qëllim të një zbatimi siç duhet të kësaj Marrëveshjeje, palët do të ngrenë një Komitet këshillimor “Komiteti këshillimor”, brenda dyzet e pesë (45) ditëve nga data efektive. Komitet këshillimor do të ketë detyrat e parashtruara në nenin 5.1.5.

5.1.2 Albpetroli dhe Kontraktori do të caktojnë secili nga tre (3) përfaqësues dhe përfaqësues alternativ, për të formuar Komitetin këshillimor dhe secila palë do të përcaktojë njërin prej përfaqësuesve të tij, si përfaqësues shef. Të gjithë përfaqësuesit në fjalë do të kenë të drejtën për të paraqitur pikëpamjet e tyre mbi propozimet, në takimet e mbajtura nga Komiteti këshillimor dhe të deklarojnë votën e tyre, kur ndonjë vendim është për t’u marrë. Kryetar i Komitetit këshillimor do të jetë përfaqësuesi shef i caktuar nga Kontraktori dhe nënkryetar do të jetë përfaqësuesi shef i Albpetrolit. Kryetari i Komitetit këshillimor do të kryesojë takimet e Komitetit këshillimor. Secili përfaqësues do të ketë një votë, në të gjitha takimet e Komitetit këshillimor. Në përputhje me nevojën, palët mund të caktojnë një numër të arsyeshëm pjesëmarrësish shtesë, të cilët do të ndjekin, por nuk do të titullohen, për të votuar në takimet e Komitetit këshillimor. Secila palë do t’i njoftojë palës tjetër emrat e përfaqësuesve të saj brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data efektive dhe do të njoftojë me shkrim në rast të ndonjë zëvendësimi të ndonjë prej këtyre përfaqësuesve. Përfaqësuesit alternativ do të zëvendësojnë përfaqësuesit kryesorë, në mungesë të këtyre të fundit.

5.1.3 Me qëllim që të jetë i vlefshëm, çdo vendim që kërkohet për t’u marrë nga Komiteti këshillimor, duhet të ketë votë pohuese të paktën të katër (4) përfaqësuesve të pranishëm në takim, pavarësisht personalisht ose me konferencë telefonike, është e kuptueshme, që asnjë vendim i tillë nuk do të jetë i vlefshëm, nëse të paktën katër (4) përfaqësues të Albpetrolit dhe Kontraktorit të jenë prezent në takim ose prezent, ose me konferencë telefonike. Vendimet e marra nga Komiteti këshillimor do të regjistrohen dhe firmosen, si në emër të Albpetrolit dhe të Kontraktorit, në fund të një mbledhjeje të tillë të Komitetit këshillimor.

Kontraktori do të përgatisë protokollin e takimit brenda tridhjetë (30) ditëve dhe do t’ia dërgojë atë për aprovim palëve. Mospërgjigjja nga një palë brenda njëzet e një (21) ditëve, pas marrjes, do të gjykohet si një aprovim nga një palë e tillë.

5.1.4 Komiteti këshillimor do të mbahet të paktën dy herë në çdo vit fiskal dhe kur të kërkohet nga Albpetroli ose Kontraktori, i kushtëzuar me një njoftim paraprak prej 15 ditësh tek anëtarët e tij, njoftim i cili do të përfshijë axhendën për takimin.

Vendime mund të merren nga Komiteti këshillimor nëpërmjet një rezolute me shkrim të firmosur nga të gjashtë përfaqësuesit ose përfaqësuesit alternativ të tyre.

5.1.5 Sipas kësaj Marrëveshjeje, Komiteti këshillimor do të ketë funksionet dhe përgjegjësitë, si më poshtë:

5.1.5.1 të sigurojë mundësinë për dhe të inkurajojnë shkëmbimin e informacionit, pikëpamjeve, ideve dhe sugjerimeve, në lidhje me planet, performancën dhe rezultatet e fituara sipas Marrëveshjes;

5.1.5.2 të shqyrtojë principet e ngritura nga Kontraktori, herë pas here, për të drejtuar aspekte ose aktivitete të ndryshme të operacioneve hidrokarbure dhe të propozojë për këtë qëllim, procedura dhe udhëzime, siç mund të gjykohet të nevojshme;

5.1.5.3 të shqyrtojë dhe aprovojë programet vjetore, të propozuara nga Kontraktori, për periudhën e zhvillimit dhe prodhimit dhe të propozojë rishikime në përputhje me nenin 8.3;

5.1.5.4. të shqyrtojë programet vjetore dhe buxhetet e propozuara nga Kontraktori, për periudhën e vlerësimit dhe çdo periudhë të re vlerësimi;

5.1.5.5 të shqyrtojë dhe aprovojë zonat e zhvillimit dhe prodhimit dhe planin e zhvillimit që Kontraktori në emër të palëve, planifikon të propozojë tek AKBN-ja, për aprovim prej saj;

5.1.5.6 të bashkëpunojë për zbatimin e programeve vjetore dhe buxheteve, dhe planit të zhvillimit;

5.1.5.7 dhe funksione të tjera të tilla, siç do t’i besohen nga palët.

5.1.6 Sidoqoftë, këtu bihet dakord midis palëve që vendimet e mëposhtme i rezervohen dhe bëhen vetëm nga Kontraktori:

5.1.6.1 vendndodhjen, shpimin, testimin, kompletimin, marrjen në dorëzim të puseve për rikompletim dhe abandonim të çdo pusi, pavarësisht se është për prodhim nafte apo për operacione hidrokarbure të tjera, duke përfshirë pa kufizim programet, metodologjinë dhe teknologjinë, që do të përdoret në kryerjen e aktiviteteve të mësipërme;

5.1.6.2 programet vjetore dhe buxhetet gjatë periudhës së vlerësimit; dhe

5.1.6.3 sipërfaqet për heqje dorë sipas Marrëveshjes.

## 5.2 Operatori

5.2.1 Nëse Kontraktori përbëhet nga më shumë se një kompani, Kontraktori do të zgjedhë një kompani të veprorë si operator, i cili do të kryejë operacionet hidrokarbure në zonën e projektit, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare, të vendburimeve të naftës. Kur Kontraktori përbëhet prej një entiteti të vetëm, ky entitet është operatori.

5.2.2 Emërimi i një operatori pasardhës do të jetë subjekt i aprovimit paraprak të Albpetrolit, aprovim i cili nuk do të kundërshtohet në mënyrë të paarsyeshme, me kusht që nuk kërkohet një aprovim i tillë, dhe vetëm njoftim me shkrim duhet të jepet, nëse operatori pasardhës është një kompani ose është një filial i një kompanie, në atë kohë.

## Neni 6 Vlerësimi

6.1 Kontraktori do të kryejë programin e vlerësimit. Nëse në përfundim të njëzet e katër (24) muajve duke përfshirë një periudhë prej (60) muajsh për të mbledhur të gjitha të dhënat e nevojshme nga vendburimi i Kuçovës dhe një periudhë prej (18) muajsh për zbatimin e programit të punës, plus një zgjatje prej (6) muajsh, e cila do të aprovohet nga AKBN-ja për Kontraktorin (aprovim i cili nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme) në vijim të datës efektive, Kontraktori dështon të shpenzojë 1 500 000 \$US për kryerjen e aktiviteteve, që përbëjnë programin e vlerësimit, atëherë Kontraktori do t'i paguajë AKBN-së një shumë të barabartë me pjesën e parealizuar të angazhimit financiar minimal të programit të vlerësimit, siç specifikohet në aneksin D.

Në rast vonese të pagesës së shpërblimit, për t'iu paguar AKBN-së në aplikim të këtij neni 6.1, sasia në lidhje me këtë, do të mbartë interes të llogaritur nga data përfundimtare në të cilën shpërblimet duheshin paguar, dhe deri në kohën kur pagesa bëhet nga Kontraktori, me një normë vjetore të diskauntit të London Inter Bank Offered Rate (Libor) plus një për qind.

6.2 Nëse Albpetroli, bie dakord që Kontraktori mund të kryejë punë në lidhje me zonën e kontratës para datës efektive, dhe me aprovim të AKBN-së, këto kosto të shkuara, të kryera në këtë mënyrë, do të trajtohen si kosto hidrokarbure dhe puna do të jetë (e pjesshme) në realizimin e detyrimeve të Kontraktorit sipas nenit 6.1.

6.3 Kontraktori ka të drejtë të shpenzojë më shumë se 1 500 000 \$US dhe të shtrijë programin e vlerësimit për të përfshirë punë dhe aktivitete shtesë në puse shtesë, brenda zonës së projektit, nëse ai zgjedh të veprorë kështu gjatë periudhës së vlerësimit.

6.4 Kontraktori ka të drejtë të përfundojë këtë Marrëveshje pa gjobë gjatë fazës së vlerësimit, me kusht që angazhimi i shpenzimeve minimale prej 1 500 000 \$ të jetë realizuar.

## Neni 7 Zhvillimi dhe prodhimi

7.1 Plani i zhvillimit do të përgatitet mbi bazën e principeve inxhinierike, mjedisore dhe ekonomike më me zë, në përputhje me praktikën përgjithësisht të pranuar të industrisë ndërkombëtare të naftës.

7.2 Plani i zhvillimit do të përmbajë, por pa u kufizuar:

7.2.1 detajet dhe shtrirjen e sipërfaqes së zonës së zhvillimit dhe prodhimit të propozuar;

7.2.2 propozime në lidhje me rrjetin, shpimin dhe kompletimin e puseve, teknologjitë, instalimet e prodhimit dhe grumbullimit dhe pajisjet e transportit dhe livrimit të kërkuara për prodhimin, grumbullimin dhe transportin e naftës;

7.2.3 propozime në lidhje me investimet për infrastrukturën e nevojshme;

7.2.4 një parashikim të prodhimit dhe një vlerësim të investimeve dhe shpenzimeve të përfshira;

7.2.5 një vlerësim të kohës së kërkuar për të përfunduar çdo fazë të planit të zhvillimit;

7.2.6 pikën e livrimit dhe pikën e matjes së propozuar.

Albpetroli mund t'i kërkojë Kontraktorit, që të japë informacion të tillë shtesë, siç mund të jetë pa vështirësi i disponueshëm dhe siç mund të ketë nevojë AKBN-ja në mënyrë të arsyeshme, për të vlerësuar planin e zhvillimit, për zonën e zhvillimit dhe prodhimit. Kjo kërkesë për informacion

duhet të bëhet brenda dyzet e pesë (45) ditëve pas marrjes së planit të zhvillimit dhe prodhimit dhe Kontraktori do të bëjë përpjekjet e arsyeshme për t'iu përgjigjur brenda dyzet e pesë ditëve.

7.3 Nëse AKBN-ja nuk kërkon me shkrim ndonjë ndryshim ndaj planit të zhvillimit brenda dyzet e pesë (45) ditëve, pas dorëzimit të planit të zhvillimit ose planit të zhvillimit, të rishikuar, siç është aprovuar nga palët, plani ose plani i amenduar do të gjykohet i aprovuar nga AKBN-ja.

7.4 Nëse AKBN-ja kërkon ndonjë ndryshim ndaj planit të zhvillimit, atëherë palët dhe AKBN-ja do të takohen brenda tridhjetë (30) ditëve të marrjes nga Kontraktori të njoftimit me shkrim për AKBN-në, në lidhje me këto ndryshime të kërkuara dhe do të përpiqen në mirëbesim të arrijnë një marrëveshje mbi planin e zhvillimit. Nëse bihet dakord, brenda një periudhe tjetër, prej tridhjetë (30) ditësh, ndryshimet në planin e zhvillimit duhet të përfshihen në një plan zhvillimi, i cili atëherë do të gjykohet i aprovuar nga AKBN-ja.

Nëse nuk arrihet marrëveshje, secila palë mund të paraqesë mosmarrëveshjen për përcaktim ekspertit, në përputhje me licencëmarrëveshjen.

Nëse Kontraktori dëshiron të amendojë materialisht planin e zhvillimit të aprovuar nga AKBN-ja, ai duhet t'i japë AKBN-së amendimet e propozuara, në përputhje me procedurat e parashtruara në këtë neni 7.4.

7.5 Pasi plani i zhvillimit të jetë aprovuar, të paktën nëntëdhjetë (90) ditë para fundit të secili vit fiskal, Kontraktori do të paraqesë në Komitetin këshillimor një deklaratë të detajuar të programit vjetor dhe buxhetit për vitin fiskal pasardhës, në lidhje me zonën e zhvillimit dhe prodhimit. Për vitin fiskal të parë të plotë dhe për pjesën e vitit fiskal para vitit fiskal të parë të plotë, si rezultat do të paraqitet në AKBN, brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas datës së aprovimit të planit të zhvillimit, sipas neneve 7.3 ose 7.4 një deklaratë e detajuar e programit vjetor dhe buxhetit. Si rrjedhim, secila deklaratë e tillë vjetore e programit vjetor dhe buxhetit, do të jetë në përputhje me planin e zhvillimit të aprovuar sipas nenit 7.3 ose siç rishikohet në përputhje me nenet 7.4 dhe 7.6.

7.6 Palët në çdo kohë mund të paraqesin në AKBN për aprovim, rishikime ndaj planit të zhvillimit ose programit vjetor dhe buxhetit. Këto rishikime do të jenë në përputhje me klauzolat e nenit 7.1, dhe në rastin e rishikimeve të planit të zhvillimit do të jenë subjekt i procedurës së aprovimit, dhënë në nenet 7.3 dhe 7.4 dhe në rastin e programit vjetor dhe buxhetit të shqyrtimit, siç jepet në nenin 5.1.5.3.

7.7 Kur Albpetroli dhe Kontraktori bien dakord që mund të arrihet një përfitim ekonomik reciprok, duke ndërtuar dhe operuar me pajisje të përbashkëta (duke përfshirë, por pa u kufizuar në rrugë, tubacione dhe pajisje transporti, komunikimi dhe grumbullimi), Albpetroli dhe Kontraktori do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të arritur marrëveshje njëri me tjetrin, dhe nëse do të jetë e nevojshme me prodhues të tjerë mbi ndërtimin, dhe operimin e këtyre pajisjeve të tilla të përbashkëta, rikuperimin e investimeve dhe pagesat që duhen bërë.

## Neni 8

### **Programet vjetor dhe buxhetet**

8.1 Po qe se nuk jepet ndryshe këtu, Kontraktori do të fillojë kryerjen e operacioneve hidrokarbure, për pusët e përshkruara në aneksin D, tridhjetë (30) ditë pasi Albpetroli njofton Kontraktorin që Marrëveshja hidrokarbure është aprovuar nga Këshilli i Ministrave. Procedura për transferimin e asetëve, operacioneve dhe përgjegjësive, që lidhen me këto puse dhe pajisjet e lidhura me ato, do të jenë siç përshkruhet në aneksin F.

8.2 Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, pas datës efektive, palët do të paraqesin tek AKBN-ja program vjetor dhe buxhet, duke parashtruar operacionet hidrokarbure të cilat Kontraktori i propozon për t'u kryer (ose tashmë ka filluar kryerjen) gjatë periudhës së vlerësimit. Në përputhje me nenin 6.3, ky program vjetor dhe buxhet do të jetë konsistent me programin e vlerësimit, por me gjykim të Kontraktorit, ai mund të përfshijë më shumë aktivitete dhe buxhete kapitale sesa programi i vlerësimit. Gjatë periudhës së vlerësimit nuk kërkohet as aprovimi i Albpetrolit dhe as i Komitetit këshillimor për ndonjë program vjetor dhe buxhet. Kontraktori mund të kërkojë amendimin e programit vjetor dhe buxhetit gjatë periudhës së vlerësimit, për aq kohë sa ky program vjetor dhe buxhet i rishikuar përfshijnë të paktën aktivitetet dhe buxhetin kapital të programit të vlerësimit. Një kopje e secilit program vjetor dhe buxhet do t'i jepet nga Kontraktori Albpetrolit dhe AKBN-së.

8.3 Të paktën nëntëdhjetë (90) ditë para fundit të vitit fiskal të parë, pas aprovimit të planit të

zhvillimit, dhe çdo vit fiskal pas tij, ose në kohë të tilla siç do të bihet dakord nga palët, Kontraktori do të përgatisë dhe dorëzojë në Komitetin këshillimor, për aprovim një program vjetor dhe buxhet të propozuar për vitin fiskal pasardhës. Çdo program vjetor dhe buxhet do të jetë konsistent me planin e zhvillimit. Nëse përfaqësuesit e Albpetrolit në Komitetin këshillimor dëshirojnë të propozojnë një rishikim në lidhje me disa veçori specifike të programit vjetor dhe buxhetit në fjalë, brenda njëzet e një (21) ditëve pas marrjes nga Komiteti këshillimor, ai do të njoftojë njësoj Kontraktorin, duke specifikuar me detaje të arsyeshme arsyet e tij për këtë. Menjëherë pas kësaj, palët do të takohen dhe do të përpiqen të bien dakord mbi rishikimin e propozuar nga përfaqësuesit e Albpetrolit. Kontraktori do t'i japë atë që i takon, në lidhje me propozimet e përfaqësuesve të Albpetrolit, me kusht që Albpetrolit do t'i kërkohet të aprovojë çdo program vjetor dhe buxhet që është konsistent me planin e zhvillimit dhe çdo rishikim i propozuar ndaj një programi vjetor dhe buxheti, që janë konsistent me planin e zhvillimit, nuk ka nevojë të pranohet nga Kontraktori. Në rast të lindjes së ndonjë konflikti, në lidhje me aprovimin e një programi vjetor dhe buxheti, në përputhje me nenin 19.10, çështja do të çohet për përcaktim ekspertit. Para zgjidhjes së çdo konflikti të tillë, programi vjetor dhe buxheti i propozuar nga Kontraktori, do të gjykohet i aprovuar për qëllime operacionesh të brendshme gjatë zgjidhjes.

8.4 Palët bien dakord të drejtojnë Komitetin këshillimor për të aprovuar programin vjetor dhe buxhetin në një kohë të përshtatshme në mënyrë të tillë që të lejojnë dërgimin e programit vjetor dhe buxhetit të propozuar për tek AKBN-ja, brenda periudhës së kohës së përcaktuar në licencëmarrëveshje.

8.5 Pranohet nga palët që detajet e një programi vjetor dhe buxheti mund të kërkojnë ndryshime në dritën e kushteve ekzistuese, dhe në këtë mënyrë Kontraktori mund t'i bëjë këto ndryshime, me kusht që ato nuk ndryshojnë objektivin e përgjithshëm të programit vjetor dhe buxhetit. Çdo rishikim ndaj programit vjetor dhe buxhetit që sjell një përshpejtim të aktiviteteve që parashikohen nga plani i zhvillimit, ose që zgjeron aktivitetet që parashikohen nga plani i zhvillimit, do të aprovohen nga Komiteti këshillimor. Në përputhje me licencëmarrëveshjen, një kopje e tillë e programit vjetor dhe buxhetit do të dërgohen tek AKBN-ja për aprovim.

8.6 Pranohet nga palët që shpenzimet në buxhet mund të kërkojnë ndryshime nën dritën e kushteve ekzistuese dhe në këtë mënyrë Kontraktori mund t'i bëjë këto ndryshime, me kusht që objektivi i përgjithshëm i programit vjetor nuk ka ndryshuar. Çdo rishikim ndaj buxhetit, që sjell një përshpejtim të aktiviteteve që parashikohen nga programi vjetor ose plani i zhvillimit, ose që zgjeron aktivitetet e parashikuara nga programi vjetor ose plani i zhvillimit, nuk do të kërkojnë aprovimin e Komitetit këshillimor.

8.7 Pranohet më tej, se në rast emergjence, që kërkon veprim të menjëhershëm, Kontraktori mund të marrë të gjitha veprimet, që ai i gjykon të përshtatshme, që mbrojnë interesat e tij, dhe ato të punonjësve të tij dhe çdo kosto që kërkohet për këtë qëllim do të përfshihet në kostot për operacione hidrokarbure. Një gjendje emergjence do të ekzistojë kur jeta, shëndeti ose pasuria, rrezikohen nga kushtet ekzistuese, ose kushte potenciale të tilla si fontanime, zjarre, eksplozione, përplasje, kushte serioze moti, akte lufte, vandalizmi ose sabotimi.

## Neni 9

### Pjesa e Albpetrolit dhe rikuperimi i kostove

9.1 Kontraktori do të sigurojë të gjitha fondet e kërkuara për të kryer operacionet hidrokarbure, sipas kësaj Marrëveshjeje. Kontraktori do të ketë të drejtën të përdorë pa pagesë naftën e prodhuar nga zona e projektit, në masën që ai e konsideron të nevojshme, për naftën e prodhuar nga zona e projektit, në masën që ai e konsideron të nevojshme, për operacionet hidrokarbure, sipas kësaj Marrëveshjeje. Fonde të tilla do të parashikohen në programin vjetor të punës dhe buxhetit.

9.2 Nafta e disponueshme do të matet në pikën e matjes dhe do të alokohet siç jepet në këtë Marrëveshjeje. Nafta e disponueshme do të alokohet ndërmjet Albpetrolit "Pjesa e Albpetrolit" dhe Kontraktorit "Nafta për rikuperimin e kostove", bazuar në faktorin R të përcaktuar më poshtë, siç jepet në tabelën e mëposhtme:

Faktori R	Pjesa e Albpetrolit	Nafta për mbulim kostoje
$R \leq 1.0$	1%	99%

1.0<R≤1.5	2%	98%
1.5<R≤2.0	3%	97%
R>2.0	4%	96%

Pjesa e Albpetrolit do të merret në naftë dhe do të livrohet tek Albpetroli në natyrë, në zonën e kontratës në:

Faktori R llogaritet si më poshtë:

$$R_n = \frac{A_k}{B_k}$$

ku:

$R_n$  do të thotë faktori R, në tremujorin kalendarik N.

$A_k$  do të thotë shuma e të ardhurave të Kontraktorit minus taksën për naftën fitim të shtuar në tremujorin kalendarik N dhe të gjithë tremujorët kalendarik të mëparshëm, në vijim të datës efektive.

$B_k$  do të thotë shuma e kostove hidrokarbure në tremujorin kalendarik N dhe të gjithë tremujorët kalendarik të mëparshëm, pas datës efektive.

Çdo rirregullim në titullim për tremujorin kalendarik aktual do të shpërndahet mbi tremujorin kalendarik tjetër në një mënyrë, që pala që është titulluar ndaj naftës së disponueshme shtesë për tremujorin kalendarik aktual, do të marrë sasinë e rirregulluar në proporcione të barabarta mujore, si shtesë ndaj titullimeve të tij të rregullt. Nëse prodhimi në ndonjë muaj është i pamjaftueshëm për të dhënë sasinë e rirregullimit, atëherë titullimi i pa dhënë do të mbartet për më vonë dhe do të shpërndahet në mënyrë të barabartë gjatë muajve të mbetur të tremujorit kalendarik aktual.

Përcaktimi i faktorit R fillimisht do të bëhet për tremujorin kalendarik të parë, në vijim të datës efektive.

9.3 Kontraktori do të titullohet për naftën për rikuperim kostoje, për të rikuperuar të gjitha kostot hidrokarbure të mbartura nga ai brenda ose të lidhura me zonën e projektit “Rikuperim i kostos”. Kostot hidrokarbure do të jenë siç përshkruhen në aneksin B.

9.4 Pasi Kontraktori ka rikuperuar të gjitha kostot hidrokarbure të tij nga nafta për mbulim kostoje, nafta për rikuperim kostoje e mbetur do të jetë “Naftë fitim”. Për shkak të riskut për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, sipas Marrëveshjes hidrokarbure, Kontraktori do të titullohet për 100% të naftës fitim.

## Neni 10

### **Punësimi**

10.1 Kontraktori do të zgjedhë ekipin drejtues të tij dhe punonjësit sipas zgjidhjes së tij, dhe do të përcaktojë kushtet e punësimit dhe numrin e punonjësve që do të përdoren për operacionet hidrokarbure. Sidoqoftë, Kontraktori dhe nënkontraktorët e tij, do të punësojnë, në masën e mundur shqiptarë të kualifikuar për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, duke i dhënë prioritet personelit të Albpetrolit, nëse aftësitë profesionale, njohja dhe ekspertiza e tyre përputhet me kërkesat operacionale. Nga ana tjetër, Kontraktori do të jetë i lirë të punësojë profesionistë të huaj të tillë, siç do ta gjykojë ai të nevojshëm. Marrëdhëniet e punës, përsa i përket kontratave të punësimit dhe të drejtave dhe detyrimeve të të punësuarve shqiptarë do të jenë në përputhje me ligjin shqiptar (Kodin e Punës).

## Neni 11

### **Titullimi ndaj asetëve**

#### 11.1 Pasuria e tundshme

11.1.1 Në bazë të licencëmarrëveshjes, titullimi ndaj asetëve në posedim të Kontraktorit në lidhje me operacionet hidrokarbure, do të transferohet tek AKBN-ja, në kohën që kostot e këtyre asetëve të patundshme dhe të tundshme janë rikuperuar plotësisht si kosto hidrokarbure ose në kohën e mbylljes, ose heqjes dorë prej operacioneve hidrokarbure, cilado që ndodh e para, të gjitha këto asete që janë në kushte të mira pune, të konsumuara normalisht dhe shkallë normale të pranueshme.

Sidoqoftë, Kontraktori mban të drejtën e përdorimit të plotë dhe lirshëm të aseteve të përmendura më parë gjatë afatit të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë ato të instaluar para datës efektive.

Çdo aset i tundshëm, mund t'i shitet një pale të tretë, me aprovim paraprak të AKBN-së, aprovim i cili nuk do të kundërshtohet në mënyrë të paarsyeshme. Të ardhurat nga shitja e çdo aseti do të përdoren nga Kontraktori si një rikuperim i kostove hidrokarbure.

11.1.2 Pavarësisht nenit 11.1.1 më sipër, bihet dakord posaçërisht që çdo aset që i përket një pale të tretë ose filialeve dhe i marrë me qira nga Kontraktori për qëllime të operacioneve hidrokarbure, dhe çdo aset i zotëruar nga nënkontraktorët ose filialet e tyre, nuk do të bëhen pasuri e AKBN-së.

11.1.3 E ardhura nga përdorimi nga palët e treta e artikujve të cilët në përputhje me nenin 11.1.1 bëhen pasuri e AKBN-së, do të kreditohen në llogarinë e kostove gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje.

11.2 Pasuria e patundshme

11.2.1 Të dhënat origjinale

Me mbylljen e licencëmarrëveshjes, Kontraktori do të dorëzojë tek AKBN-ja të gjitha të dhënat origjinale. Të gjitha këto të dhëna origjinale (duke përfshirë, por pa u kufizuar në ato sizmike, gjeofizike, gjeologjike, gravimetrike, magnetometrike, karrotazhe, shpimin, prodhimin, ndërtimin, projektimin etj.) do të bëhen pasuri e Qeverisë Shqiptare.

Kontraktori do ta furnizojë Albpetrolin me këto të dhëna, mbi një bazë të vazhdueshme.

Sidoqoftë, Kontraktori ose marrësit e interesave të tij, siç përcaktohet në nenin 1.17 dhe nenin 16, do të titullohen për të mbajtur dhe përdorur lirshëm kopje të këtyre të dhënave, dhe për rrjedhojë do t'u jepet një licencë e përhershme, jo ekskluzive dhe pa *royalty*, për t'u përdorur dhe nënlicencë për përdorim të të dhënave në fjalë.

11.2.2 Të dhënat e interpretuara

Të dhënat e interpretuara mbi bazën e të dhënave origjinale të referuara në seksionin 11.2.1 më sipër, pavarësisht se janë krijuar nga Kontraktori, nga filialet e tij ose palë të treta, me shpërblim të Kontraktorit, do të mbeten e vetmja pasuri e Kontraktorit dhe sipas nenit 23 të Marrëveshjes, do të konsiderohet si informacion konfidencial.

Sidoqoftë, Albpetroli është i titulluar të marrë kopje të të gjitha raporteve përfundimtare në lidhje me të dhënat e mësipërme, dhe do t'i përdorë ato vetëm për nevojat e tij.

## Neni 12

### **Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

12.1 Prej datës efektive, Kontraktorit do t'i jepet e drejta të përdorë:

Në mënyrë ekskluzive, pa pagesë të gjitha mjetet dhe pajisjet në zonën e kontratës, për kryerjen e operacioneve hidrokarbure për:

i) zbatimin e operacioneve të vlerësimit, si dhe operacioneve të zhvillimit dhe prodhimit;

ii) aplikimin e metodave IOR/EOR në të gjithë zonën e kontratës dhe në përputhje me kushtet dhe termat e kësaj Marrëveshjeje; dhe

iii) prodhimin e naftës në zonën e projektit,

por pa cenuar materialisht, në të kundërt operacionet e Albpetrolit, jashtë zonës së projektit.

e) pa pagesë, dhe për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, të gjitha asetet, pajisjet, mjetet dhe infrastrukturën tjetër (duke përfshirë rrugët, linjat e furnizimit me energji dhe ujë, tubacionet e naftës dhe gazit) që ekzistojnë në zonën e kontratës ose të vendosura në të, në datën efektive të kësaj Marrëveshjeje, por (po qe se nuk bihet dakord ndryshe me furnizuesin) në përputhje me pagesën, mbi një bazë jodiskriminuese, me kosto të arsyeshme për elektricitet, ujë naftë dhe gaz të përdorur;

f) sipas kushteve dhe termave komercialisht të arsyeshme, tubacionet që transportojnë naftën e prodhuar në zonën e kontratës, në portet dhe rafineritë në Shqipëri; dhe

g) Të gjitha të dhënat teknike të disponueshme në AKBN, që kanë të bëjnë me zonën e kontratës, me kusht që Kontraktori do të rimbursojë AKBN-në për të gjitha kostot e arsyeshme të kryera për përgatitjen e transferimit të këtyre të dhënave, dhe koston për bërje kopje këtyre të dhënave.

12.2 Kontraktori do të ketë të drejtën, gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje të marrë, të trajtojë, transportojë, disponojë dhe eksportojë lirshëm pjesën e tij të naftës, dhe të mbajë jashtë shtetit



të ardhurat e fituara prej saj.

12.3 Kontraktori do të sigurojë të gjitha fondet e nevojshme dhe do të mbartë të gjitha kostot dhe shpenzimet e kërkuara për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, sipas kësaj Marrëveshjeje, përveçse në masën siç jepet ndryshe në këtë Marrëveshjeje.

12.4 Kontraktori do të përpiqet të arrijë përdorim eficient dhe zhvillim të sigurt për prodhimin e naftës dhe të optimizojë nxjerrjen ekonomike përfundimtare të naftës nga zona e projektit.

12.5 Kontraktori do të sigurojë, që të gjitha materialet, pajisjet, mjetet e përdorura në operacionet hidrokarbure të përputhen me normat inxhinierike përgjithësisht të pranuar, janë me ndërtim siç duhet dhe janë mbajtur me nivel optimal pune.

12.6 Kontraktori do të blejë ose marrë me qira të gjitha pajisjet, materialet, shërbimet dhe furnizimet e kërkuara për t'u blerë ose marrë me qira në përputhje me programin vjetor.

12.7 Kontraktori do të informojë Albpetrolin me të gjitha aktivitetet që do të kryhen sipas kësaj Marrëveshjeje dhe do ta furnizojë Albpetrolin me raporte javore të prodhimit të vlerësuar të naftës:

h) raporte mujore mbi prodhimin e naftës dhe operacionet hidrokarbure; dhe

i) raporte tremujore mbi kostot e naftës.

12.8 Kontraktori do të lejojë përfaqësuesit e Albpetrolit të inspektojnë në të gjitha kohët e arsyeshme, (por me njoftim të arsyeshëm) operacionet hidrokarbure, sipas kësaj Marrëveshjeje, me kusht që ky inspektim nuk pengon në mënyrë të paarsyeshëm operacionet hidrokarbure.

12.9 Kontraktori do të mbajë të gjitha regjistrimet origjinale në zyrën e tij në Shqipëri të gjitha operacioneve teknike të naftës, sipas kësaj Marrëveshjeje, për një periudhë jo më pak se njëzet e katër (24) muaj dhe më pas Kontraktori ka të drejtë t'i arkivojë regjistrimet origjinale në një vend alternativ. Kostot e kryera për këtë janë plotësisht të pagueshme si kosto hidrokarbure.

12.10 Albpetroli dhe AKBN-ja do të sigurojnë që Kontraktori të ketë përdorim të hekurudhave, rrugëve, autostradave, ujit, sipërfaqes së tokës, lëndës drusore, elektricitetit, strukturës sanitare dhe infrastruktura të tjera në Shqipëri, me tarifa komercialisht të arsyeshme dhe mbi një bazë jodiskriminuese, në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë të tillë siç mund të jetë e mundur:

të kryejë operacionet hidrokarbure në përputhje me këtë Marrëveshjeje; dhe

të prodhojë, transportojë, eksportojë dhe shesë naftë në ose nga Shqipëria, siç jepet në këtë Marrëveshjeje dhe ligjin për hidrokarburet.

12.11 Albpetroli dhe AKBN-ja do të sigurojnë, që Kontraktorit i janë dhënë në përputhje me nenet 7 dhe 10 të ligjit për hidrokarburet, të gjitha të drejtat, lejet, licencat, aprovimet dhe autorizimet e tjera që ai mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, me qëllim që të kryejë operacionet hidrokarbure në përputhje me këtë Marrëveshjeje dhe që çdo kompensim, i cili mund t'i kërkohet për t'u paguar nga Kontraktori, në përputhje me nenin 10(2) të ligjit hidrokarbur, do të jetë i arsyeshëm dhe jodiskriminues.

12.12 Albpetroli dhe AKBN-ja do t'i venë në dispozicion Kontraktorit të gjitha të dhënat teknike, që disponohen nga Albpetroli ose AKBN-ja në lidhje me zonën e kontratës, me kusht që Kontraktori do ta rimburojë Albpetrolin ose AKBN-në për të gjitha kostot e arsyeshme të kryera, për pengatitjen e transferimit të këtyre të dhënave dhe koston për kopjimin e këtyre të dhënave.

12.13 Kontraktori do të rezervojë dhe mbajë çdo kampion dhe solucion shpimi të marrë nga shpimi i pusit në mënyrën, vendin dhe kohën e përcaktuar nga AKBN-ja me rregullore të veçantë. Të gjitha kampionet e marra nga Kontraktori, për qëllimet e veta do të konsiderohen subjekt për t'u inspektuar nga AKBN-ja, në çdo kohë që AKBN-ja e kërkon, brenda kohës zyrtare të punës. Në përputhje me çka u tha më parë, Kontraktori do të jetë i lirë të eksportojë karotka dhe shllame për analiza jashtë shtetit. Po që se bihet dakord ndryshe me Albpetrolin, Kontraktori do t'i mbajë kampionet e këtyre karotkave dhe shllameve në sasi dhe cilësi ekuivalente në Shqipëri.

12.14 Kontraktori do të jetë i lirë të eksportojë origjinalet e regjistrimeve të të dhënave teknike jashtë shtetit, në përputhje me aprovimin e AKBN-së dhe me kushtin që një regjistrim i monitorizuar ose i krahasueshëm është mbajtur nga Kontraktori ose Albpetroli në Shqipëri.

12.15 Çdo gaz shoqërues i prodhuar në shoqërim me naftën bruto, nga zona e projektit do të jetë i disponueshëm për Kontraktorin për përdorim në operacionet hidrokarbure pa pagesë. Çdo sasi e tillë, që nuk merret nga Kontraktori, mund të digjet.

12.16 Çdo gaz shoqërues e prodhuar nga zona e kontratës, në sasinë që nuk përdoret në operacionet hidrokarbure këtu, mund të digjet në përputhje me rregullat aktuale të ambientit, nëse

përpunimi ose përdorimi i tij nuk është ekonomik, si dhe teknikisht dhe komercialisht, nuk është në gjendje për ta rinjektuar gazin shoqëruar. Kjo djegie mund të lejohet në masën, që gazi nuk kërkohet në atë masë, për të cenuar nxjerrjen ekonomike të naftës bruto, me operacione nxjerrëse sekondare, duke përfshirë ripresimin dhe riciklimin.

12.17 Palët pranojnë që natyra e të drejtave dhe detyrimeve të tyre respektive, sipas kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me zonën e kontratës, është e tillë që unitizimi i sipërfaqeve që janë të gjitha tërësisht brenda zonës së kontratës, nuk kërkohet për të mbrojtur të drejtat respektive të palëve ose për të ruajtur, ose optimizuar nxjerrjen e hidrokarbureve nga zona e kontratës.

#### Neni 13

##### **Taksimi**

13.1 Kontraktori do të jetë përgjegjës për taksën mbi fitimin, në përputhje me ligjin nr.7811, datë 12.4.1994 “Mbi aprovimin e dekretit nr.782, datë 22.2.1994 “Mbi sistemin fiskal, në sektorin hidrokarbur (Kërkim-prodhim)”, dhe i amenduar me ligjin nr.8297, datë 4.3.1998 dhe në përputhje me licencëmarrëveshjen.

13.2 Përveç taksave dhe detyrimeve doganore të parashtruara në nenin 13.1 dhe nenin 14.1 Kontraktori, filialet dhe personeli i huaj respektiv i tij do të përjashtohen nga taksat dhe detyrimet doganore shqiptare, në lidhje me të gjitha aktivitetet që lidhen me operacionet hidrokarbure, në masën siç jepet në ligjin shqiptar. Ky përjashtim, nuk përfshin pagesat normale në port, për magazinim dhe postale, dhe pagesat e tjera të zakonshme të ngjashme, për aplikim të përgjithshëm për shërbimet aktuale të kryera.

13.3 Punonjësit e huaj të Kontraktorit, nuk do të jenë subjekt i taksave dhe detyrimeve doganore ndaj ndonjë të ardhure ose fitimi të realizuar prej tyre, drejtpërdrejt ose indirekt nga puna e tyre në operacionet hidrokarbure, as mbi importimin ose rieksporimin e sendeve të tyre personale, artikuj të cilët mund të importohen lirshëm dhe për pasojë të rieksporohen.

#### Neni 14

##### **Importet dhe eksportet**

14.1 Kontraktori dhe nënkontraktorët e tij, të angazhuar në kryerjen e operacioneve hidrokarbure sipas kësaj Marrëveshjeje, do të lejohen të importojnë dhe do të përjashtohen (me përjashtim të pagesave normale portuale dhe magazinimit, me aplikim të përgjithshëm në Shqipëri, për shërbime reale të bëra për të licencuarin), nga detyrimet e importit në lidhje me pajisjet, makineritë, materialet etj., që do të përdoren për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, sipas licencëmarrëveshjes.

14.2 I njëjti përjashtim është i vlefshëm për artikujt e përdorimit personal të punonjësve të huaj të Kontraktorit dhe nënkontraktorëve të tij, që kanë lidhje me operacionet hidrokarbure.

14.3 Megjithatë, Kontraktori dhe nënkontraktorët e tij, do t'i japin prioritet mallrave dhe materialeve të prodhuara në Shqipëri, nëse këto mallra dhe materiale ofrohen sipas kushteve të favorshme të barabarta, në lidhje me cilësinë, çmimin dhe disponibilitetin dhe në sasi të kërkuara.

#### Neni 15

##### **Librat e llogarive, monedha, kontrolli i shkëmbimit dhe pagesat**

15.1 Kontraktori do të mbajë, në zyrat e tij në Shqipëri, librat e llogarive në përputhje me procedurën llogaritëse dhe me praktikën llogaritëse përgjithësisht të përdorura në industrinë ndërkombëtare të naftës, dhe në përputhje me ligjin shqiptar dhe libra llogarie dhe regjistrime të tilla të tjera, siç mund të jetë e nevojshme për të treguar punën e kryer, sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë sasinë e të gjithë naftës së disponueshme.

15.2 Kontraktori do të mbajë librat e tij të llogarisë dhe regjistrimet llogaritëse, duke përfshirë llogarinë e kostove në \$US dhe në lekë shqiptar.

15.3 Kontraktori do të mbajë një llogari bankare në \$US dhe një llogari bankare në lekë shqiptar. Të gjitha pagesat nga llogaria në \$US të bëra në monedha ndryshe nga \$US, do të regjistrohen në librat e llogarisë në \$US, me kursin e shkëmbimit, me efekt në kohën e transaksionit. Vlerësimi i bërë në monedha ndryshe nga \$US do të regjistrohet në librat e llogarisë në \$US, me

kurset dhe me efekt në kohën e kryerjes së vlerësimit. Kursi i këmbimit, për vlerësime të tilla, do të vendoset duke përdorur mesataren e kurseve të blerjes dhe shitjes së monedhës, për ditën në të cilën kryhet transaksioni, siç kuotohet në financial times (London Edition), ose kurse të tilla të tjera të kuotuara, siç mund të bihet dakord bashkërisht. Për transaksione që kryhen në ditët që nuk ka kurs shkëmbimi të publikuar, kursi i këmbimit do të vendoset me referencë ndaj kursit të publikuar, në datën e menjëhershme të mëparshme të botimit.

Të gjitha pagesat në lekë shqiptar do të konvertohen në \$US, me kursin mesatar zyrtar të blerjes, siç jepet nga Banka Qendrore e Shqipërisë, për muajin në të cilin shpenzimet/kreditimet janë regjistruar në librat e llogarive.

As Albpetroli dhe as Kontraktori, nuk do të provojnë një humbje ose fitim me shkëmbim për llogari të ose në përfitim të palës tjetër. Çdo humbje ose fitim në shkëmbim të monedhës, që rezultojnë nga diferencat ndërmjet kurseve të shkëmbimit për procedura llogaritëse, siç përmendet më sipër dhe kurset e këmbimit aktual, kur blihet monedha korresponduese, jo \$US, për qëllim të pagesës, vazhdimisht do të ngarkohet ose kreditohet në llogarinë e kostove.

15.4 Çdo pagesë që i kërkohet Albpetrolit, për ta bërë të Kontraktori ose i kërkohet Kontraktorit ta bëjë tek Albpetroli do të bëhet në \$US, por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë, pas fundit të muajit, në të cilën ndodh detyrimi për ta bërë këtë pagesë.

15.5 Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, Kontraktori do të ketë liri të plotë të:

15.5.1 hapë, operojë dhe mbajë llogari bankare, brenda dhe jashtë Shqipërisë;

15.5.2 marrë dhe mbajë jashtë Shqipërisë dhe disponojë lirshëm jashtë Shqipërisë monedhën e huaj të marrë prej tij, duke përfshirë të ardhurat e shitjes së naftës këtu, dhe Kontraktori nuk do të jetë i detyruar t'i sjellë këto të ardhura në Shqipëri, me përjashtim të atyre të ardhurave, siç mund t'i kërkohet me gjykim të Kontraktorit, për të përmbushur shpenzimet në Shqipëri;

15.5.3 paguajë drejtpërdrejt jashtë Shqipërisë, për blerje të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme, për kryerjen e operacioneve hidrokarbure këtu;

15.5.4 paguajë punonjësit e huaj që punojnë në Shqipëri, në monedha të huaja jashtë Shqipërisë, këtyre punonjësve të huaj t'u kërkohet vetëm që të sjellin në Shqipëri monedhë të huaj, të tillë, siç mund t'u kërkohet, për t'i përmbushur shpenzimet e tyre personale të jetesës;

15.5.5 dërgojë plotësisht jashtë të gjitha të ardhurat e Kontraktorit, nga operacionet hidrokarbure në Shqipëri, duke përfshirë, por pa u kufizuar, të ardhurat nga shitja e naftës;

15.5.6 importojë dhe eksportojë lirshëm monedhë të huaj dhe mbajë brenda Shqipërisë, llogari në monedhë të huaj.

15.6 Në rast se një palë dështon ta bëjë pagesën siç jepet këtu, në datën e duhur për çdo sasi të papaguar do të paguhet interes. Normat e interesit të aplikueshëm do të jetë 3 muaj LIBOR, për depozitat në \$US, e marrë në ditën e parë të mospagimit plus 2.5%, siç botohet nga National Westminster Bank Limited, London, në orën 11 para dite.

## Neni 16

### **Dhënia e interesave**

16.1 Kontraktori nuk do të transferojë te ndonjë person, plotësisht ose pjesërisht, ndonjë prej të drejtave, privilegjeve, detyrave dhe detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, pa aprovim paraprak, me shkrim nga Albpetroli, aprovim i cili nuk do të kundërshtohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme. Çdo personi, të cilit i transferohen këto të drejta, privilegje, detyra dhe detyrime, do të jetë teknikisht dhe financiarisht kompetent, dhe ky transferim, nga një pikëpamje tjetër duhet të përputhet me kërkesat e nenit 16.3.

16.2 Pavarësisht nenit 16.1, por në përputhje me kërkesat e nenit 16.3, Kontraktori do të jetë i lirë të transferojë të drejtat, privilegjet, detyrat dhe detyrimet e tij, sipas kësaj Marrëveshjeje te një filial, pas përfundimit të njoftimit paraprak me shkrim, prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bërë tek Albpetroli për këtë transferim, me kusht që Kontraktori siguron një garanci me shkrim, për performancë të plotë nga ky filial, për të gjitha detyrat dhe detyrimet që janë për t'u transferuar, sipas kësaj Marrëveshjeje. Në çdo kohë, në vijim të një transferimi të tillë, Kontraktori i mëparshëm, që ka bërë këtë transferim, mund të kërkojë që Albpetroli të mos kërkojë më garancinë e mëparshme dhe kjo kërkesë nuk do të refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme, nga Albpetroli duke treguar që filiali, të cilit i është bërë ky transferim, posedon në mënyrë të pavarur kompetencë teknike dhe

financiare të kryejë plotësisht detyrat dhe detyrimet, të cilat janë transferuar tek ai. Çdo transferim nga Kontraktori të një filial, pa garancinë me shkrim të mëparshëm nga Kontraktori, do të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 16.1.

16.3 Në lidhje me transferimin e të drejtave, privilegjeve, detyrave dhe detyrimeve, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe licencëmarrëveshjeje, do të plotësohen kushtet e mëposhtme:

Detyrat dhe detyrimet e Kontraktorit do të plotësohen plotësisht, deri në datën kur është bërë kërkesa për aprovim ose Kontraktori do të garantojë, bashkërisht ose veçmas, kryerjen e çdo detyrimi, i cili nuk është plotësuar që prej kësaj date;

Personi, të cilit i bëhet transferimi, do t'i paraqesë Albpetrolit dëshmi me dokumente të kompetencës së tij teknike dhe/ose financiare; dhe

Instrumenti i transferit duhet të përfshijë klauzola, të cilat në mënyrë të qartë të deklarojnë që Kontraktori mbahet përgjegjës për të gjitha angazhimet që përmban kjo Marrëveshje, dhe çdo modifikim ose amendim me shkrim, që mund të jetë efektiv deri në datën e transferimit, dhe duhet deklaruar më tej, që Kontraktori nuk ka ndonjë pretendim për ndryshim të termave të kësaj Marrëveshjeje, si një kusht për transferimin. Instrumenti i transferit do të jetë subjekt për t'u rishikuar dhe aprovuar nga Albpetroli dhe Albpetroli nuk do ta kundërshtojë ose vonojë në mënyrë të paarsyeshme këtë aprovim.

16.4 Kontraktori mund t'i hipotekojë të drejtat sipas kësaj Marrëveshjeje, për qëllim të rritjes së financimit të operacioneve hidrokarbure, me pëlqim paraprak me shkrim nga Albpetroli (pëlqim i cili nuk do të kundërshtohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme).

16.5 Me transferimin e të gjitha të drejtave, privilegjeve, detyrave dhe detyrimeve të tij të një person tjetër, në përputhje me këtë nen 16, Kontraktori me bërjen e transferimit, do të pushojë të ketë ndonjë të drejtë ose interes në këtë Marrëveshje, si Kontraktor.

## Neni 17

### **Forca madhore**

17.1 Mosarritja nga ndonjë palë të plotësojë ndonjë detyrim, sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse është shkaktuar nga veprime të Zotit ose të armiqve publikë, zjarrit, eksplozionit, rreziqeve të detit, përmbytjeve, thatësisë, luftës, kryengritjeve, armiqësive, që nuk shkojnë deri në luftë, sabotimit, aksidentit, embargos, prioritetit qeveritar, marrjes ose caktimit të imponuar ose ndonjë veprimi tjetër prej ndonjë autoriteti qeveritar, ose nga ndërprerja, ose vonesa në transport, mungesa ose mosarritja e furnizimit me materiale dhe pajisje nga burime normale, grevat e punës ose nga zbatimi i ndonjë urdhri, ose kërkesë të ndonjë autoriteti qeveritar, ose ndonjë zyrtari, departamenti, agjencie ose komiteti në lidhje me to, ose ndonjë rrethane tjetër me karakter të ngjashëm, jashtë kontrollit të arsyeshëm të një pale (këtu e quajtur "Forcë madhore") nuk bën përgjegjëse atë palë, kundrejt palës tjetër. Në një rast të tillë, pala subjekt i forcës, bën të gjitha përpjekjet e saj të arsyeshme për të minimizuar efektet e një ngjarjeje të tillë, dhe për të kaluar një ngjarjeje të tillë sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur.

17.2 Me përjashtim të rasteve, kur është përcaktuar ndryshe këtu, në rastin kur nga një forcë madhore, një palë nuk ka mundur t'i kryejë detyrimet e saj, sipas kësaj Marrëveshjeje, pala, si kusht paraprak për t'u përjashtuar nga detyrimet e saj, njofton dhe jep hollësi të plota me shkrim për një ngjarje të tillë të forcës madhore të pala tjetër, brenda dhjetë (10) ditëve pas ndodhjes së shkakut, nga i cili varet dhe detyrimet e secilës palë, sa kohë që ato cenohen nga kjo forcë madhore, pezullohen gjatë vazhdimit të kësaj ngjarjeje të forcës madhore.

17.3 Në rast se për një periudhë të pandërprerë prej dy (2) vitesh në vazhdim dhe si rezultat i një ngjarjeje force madhore, ndonjë palë nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, si rezultat i kësaj ngjarjeje të forcës madhore, dhe jo si shkelje e detyrimeve këtu që janë të painfluencuara nga kjo ngjarje force madhore, kjo Marrëveshje mund të përfundohet në përvjetorin e dytë të kësaj force madhore, nga secila palë.

## Neni 18

### **Ligji drejtues**

18.1 a) Në përputhje me nenin 18.1 (b) aktivitetet e Kontraktorit në zbatimin e operacioneve

hidrokarbure do të administrohen nga dhe kryhen në përputhje me kërkesat e ligjit shqiptar.

b) Të gjitha çështjet, në lidhje me interpretimin ose imponimin e ose të drejtave dhe detyrimeve të palëve sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe të cilat janë subjekt i arbitrit, në lidhje me nenin 19, do të administrohen me ligjet e Anglisë.

18.2 Albpetroli pranon që Kontraktori ka hyrë në këtë Marrëveshje me besimin te ligjet, rregullat dhe rregulloret e Shqipërisë, ashtu siç ato ekzistojnë në datën efektive të kësaj Marrëveshjeje, dhe Albpetroli konfirmon këtu, që të gjitha të drejtat dhënë Kontraktorit, janë në përputhje me këto ligje, rregulla dhe rregullore.

18.3 Nëse, si rezultat i ndonjë ndryshimi në ligjet, rregullat dhe rregulloret e Shqipërisë, ndonjë e drejtë ose përfitim i dhënë (ose e cila synohet për t'iu dhënë) Kontraktorit, sipas kësaj Marrëveshjeje ose licencëmarrëveshjeje, cenohet në ndonjë mënyrë, një detyrim ose përgjegjësi më e madhe aplikohet ndaj Kontraktorit ose në çfarëdo mënyre tjetër përfitimet ekonomike që rrjedhin ndaj Kontraktorit nga kjo Marrëveshje ose licencëmarrëveshje, influencohen negativisht nga ndonjë ndryshim në këto ligje, rregulla dhe rregullore të Shqipërisë, dhe një gjë e tillë nuk sigurohet këtu, palët menjëherë do të amendojnë këtë Marrëveshje dhe licencëmarrëveshje, dhe Albpetroli, AKBN-ja dhe Ministria do të ndërmarrin veprime të tjera të nevojshme të menjëhershme për të eliminuar efektin ekonomik negativ ndaj Kontraktorit.

## Neni 19 **Arbitrazhi**

19.1 Çdo konflikt, mosmarrëveshje, pretendim ose ndryshim në opinion, duke përfshirë çdo mbyllje të pretenduar, sipas nenit 22, i lindur prej ose i lidhur me këtë Marrëveshje ose shkelje, mbyllje ose vlefshmëri të saj, ose ndaj operacioneve hidrokarbure të kryera këtu, do të zgjidhet përfundimisht, dhe në mënyrë vendimtare nga arbitrazhi, në përputhje me rregullat e arbitrazhit uncitral "Rregullat".

19.2 Në lidhje me çfarë u përmend më sipër, autoriteti i caktuar sipas rregullave, do të jetë president i gjyqit të Arbitrazhit Ndërkombëtar i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris, Francë.

19.3 Numri i arbitrave do të jetë tre. Pala që fillon arbitrazhin do të caktojë një arbitër dhe pala tjetër, përgjegjëse do të caktojë një arbitër tjetër, dhe nëse kjo palë përgjegjëse dështon të përcaktojë në këtë mënyrë një arbitër, brenda tridhjetë (30) ditëve, pala që fillon arbitrazhin mund t'i kërkojë autoritetit të caktuar të caktojë një arbitër të tillë, të dytë, në përputhje me rregullat. Kështu dy (2) arbitrat e caktuar në këtë mënyrë do të zgjedhin arbitrin e tretë, i cili do të veprojë si arbitër drejtues i gjyqit.

19.4 Nëse brenda tridhjetë (30) ditëve të caktimit të arbitrit të dytë, që është për t'u caktuar, dy (2) arbitrat e caktuar nuk bien dakord për arbitrin e tretë, cilado palë, mund t'i kërkojë autoritetit të caktuar arbitrin e tretë.

19.5 Arbitrazhi do të bëhet në Zurich, Zvicër. Gjuha që do të përdoret në procedurën gjyqësore të arbitrazhit do të jetë gjuha angleze. Palët në mënyrë të qartë heqin dorë nga ndonjë e drejtë për të apeluar një vendim arbitrimi në ndonjë gjykatë cilado qoftë, dhe vendimi i arbitrit do të jetë përfundimtar dhe detyrues për Palët.

19.6 Vendimi i arbitrit do të përmbajë arsyet mbi të cilën bazohet vendimi dhe një vendim të kostove.

19.7 Mbyllja e kësaj Marrëveshjeje nuk i nënshtrohet të drejtës për t'u arbitruar, sipas këtij neni 19.

19.8 Albpetroli në mënyrë të qartë heq dorë nga ndonjë e drejtë për të pretenduar në imunitetin e pavarur, në lidhje me ndonjë procedurë të filluar në përputhje me këtë nen 19, ndonjë procedurë të detyrojë zbatimin e këtij neni 19 ose ndonjë procedurë të zbatojë ndonjë vendim të bërë nga arbitrazhi, sipas këtij neni 19.

19.9 Gjykimi mbi vendimin e dhënë, mund të çohet në një gjykatë, që ka juridiksion ose kërkesë, që mund të bëhet në një gjykatë të tillë, për një pranim juridik të vendimit dhe një urdhër zbatimi siç mund të jetë rasti.

19.10 Çdo çështje në konflikt, ndërmjet Albpetrolit dhe Kontraktorit, e cila me termat e kësaj Marrëveshjeje duhet t'i referohet një eksperti ose për ndonjë konflikt në lidhje me dështimin e Komitetit këshillimor për të aprovuar një kërkesë ose propozim të Kontraktorit, do të paraqitet për

përcaktim nga një ekspert i vetëm. Ekspertit do t'i jepen termat e referencës për të cilat duhet rënë dakord reciprokisht ndërmjet palëve. Eksperti do të caktohet me marrëveshje ndërmjet Albpetrolit dhe Kontraktorit. Nëse Albpetroli dhe Kontraktori dështojnë të caktojnë një ekspert brenda tridhjetë (30) ditëve, sipas marrëveshjes mbi termat e referencës që është arritur, secila palë mund të aplikojë në Dhomën Ndërkombëtare të Qendrës Tregtare për Ekspertizë Teknike, Paris, Francë, për caktimin e një ekspertimi në përputhje me rregullat e saj. Eksperti do ta bëjë përcaktimin e tij, në përputhje me klauzolat që përmbahen këtu, bazuar në dëshminë më të mirë që i bëhet atij. Përfaqësuesit e Albpetrolit dhe Kontraktorit do të kenë të drejtë të konsultohen me një ekspert dhe t'i japin atij të dhëna dhe informacion me kusht që eksperti mund të vendosë kufizimet e arsyeshme mbi këtë të drejtë. Çdo e dhënë dhe informacion i tillë duhet të paraqitet te pala tjetër në konflikt në të njëjtën kohë. Eksperti do të jetë i lirë të vlerësojë masën ndaj të cilës çdo e dhënë, informacion ose dëshmi tjetër është e vërtetuar ose e drejtpërdrejtë. Pagesa dhe shpenzimet për ekspertin dhe kostot që lidhen me një caktim, nëse ka ndonjë, të bëra nga Dhoma Ndërkombëtare e Qendrës Tregtare për Ekspertizë Teknike, do të mbarten në mënyrë të barabartë nga Albpetroli dhe Kontraktori. Përcaktimi i ekspertit do të jetë përfundimtar dhe detyrues ndaj palëve, edhe në kushtet e ndonjë gabimi të dukshëm në përcaktimin e tij.

## Neni 20

### **Masat për mjedisin dhe sigurinë, parandalimi i humbjeve**

20.1 Kontraktori do të kryejë operacione hidrokarbure në një mënyrë të sigurt dhe siç duhet, në përputhje me praktikën përgjithësisht të pranuar të industrisë ndërkombëtare të naftës, dhe do të shkaktojë dëmtim aq të vogël sa është në mënyrë të arsyeshme e praktikueshme ndaj mjedisit të përgjithshëm, duke përfshirë midis të tjerash, sipërfaqen, ajrin, liqenet, lumenjtë, detin, botën shtazore, botën bimore, të mbjellat, burime natyrore të tjera dhe pasuri.

20.2 Në rast të një fontanimit, aksidenti ose emergjence tjetër, Kontraktori do të marrë të gjitha hapat e menjëhershme për ta sjellë situatën emergjente në kontroll, dhe mbrojtë kundrejt humbjes së jetës, ose humbjes të ose dëmtimit të pasurisë dhe të mbrojtë nga dëmtimi burimet natyrore dhe mjedisin e përgjithshëm.

20.3 Në rast se Albpetroli përcakton në mënyrë të arsyeshme, që ndonjë punë ose instalim i kryer nga Kontraktori, (por jo ato punë ose instalime të cilat gjendeshin para datës efektive ose transferohen te Kontraktori pas datës efektive) rrezikon, ose mund të rrezikojë persona ose pasuri të palëve të treta, ose shkakton ndotje, ose dëmton mjedisin në një shkallë të papranueshme, Albpetroli mund t'i kërkojë Kontraktorit, që brenda një periudhe të arsyeshme, të marrë masa rregulluese, dhe të riparojë çdo dëmtim të mjedisit.

Në rast se Kontraktori dështon të marrë masat rregulluese të kërkuara nga Albpetroli brenda periudhës së kohës së përcaktuar për këtë, atëherë Albpetroli mund të marrë masa të tilla rregulluese për llogari të Kontraktorit.

Çdo masë rregulluese e kërkuar për t'u ndërmarrë nga autoritetet e mjedisit të Qeverisë Shqiptare, në lidhje me ato punime ose instalime në zonën e kontratës, të cilat gjendeshin aty para datës efektive, ose u transferuan te Kontraktori, pas datës efektive, do të jenë për llogari të Albpetrolit.

20.4 Pas datës efektive, sa më shpejt që të jetë e mundur, Kontraktori do të dorëzojë për aprovim nga autoritetet e mjedisit një raport "Studim i nivelit bazë" mbi statusin e nivelit bazë të mjedisit për zonën e projektit, si në datën efektive. Me çdo zgjerim të zonës së projektit ose marrjen në dorëzim të puseve të reja, siç mund të jetë rasti, Kontraktori do të dorëzojë për aprovim nga autoriteti për mjedisin, një studim të nivelit bazë, mbi gjendjen e nivelit bazë të mjedisit, për pjesën e zgjeruar të zonës së projektit ose pusin e ri të marrë në dorëzim, siç mund të jetë rasti, në datën përkatëse.

20.5 Kontraktori nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë dëmtim të mjedisit të kryer para datës së aprovimit të studimit të nivelit bazë, siç jepet nga studimi ekzistues i nivelit bazë dhe çdo studim niveli bazë në vazhdimësi. Albpetroli do të zhdëmtojë dhe do të mbajë të pacenuar Kontraktorin nga dhe kundrejt ndonjë dhe të gjitha humbjeve dhe përgjegjësi të pësuar dhe ose të kryera nga Kontraktori dhe që kanë të bëjnë me dëmtimet e mjedisit të aplikueshme në zonën e kontratës, përveç se në masën që mund të demonstron, që operacionet hidrokarbure të kryera nga Kontraktori në zonën e projektit, pas datës efektive, kanë qenë shkaku i vetëm i dëmtimeve të mjedisit.

20.6 Kontraktori do të marrë të gjitha masat e nevojshme të arsyeshme, brenda kontrollit të

vet, në përputhje me standardet përgjithësisht të pranuar të industrisë ndërkombëtare të naftës, për të ndaluar humbjen ose derdhjen e naftës, mbi ose nën tokë, gjatë kryerjes së operacioneve hidrokarbure.

## Neni 21

### **Mallrat dhe shërbimet**

21.1 Kontraktori, kontraktorët dhe nënkontraktorët e tij, do t'i japin prioritet mallrave dhe materialeve të prodhuara në Shqipëri, nëse këto mallra dhe materiale ofrohen sipas kushteve favorizuese të barabarta në lidhje me cilësinë, çmimin dhe disponueshmërinë, dhe në sasi të kërkuara. Kontraktori do t'i japë prioritet shërbimeve të kryera nga nënkontraktorë shqiptarë, nëse këto shërbime sipas kushteve favorizuese të barabarta në lidhje me cilësinë, çmimin dhe disponueshmërinë që ato mund të ofrohen nga nënkontraktorë të huaj.

Për qëllimet e mësipërme, çmimet për materialet, pajisjet, makineritë dhe gjërat e konsumueshme të prodhuara brenda vendit dhe për shërbimet e kontraktorëve lokal, duhet të jenë të krahasueshme me çmimet e mallrave dhe shërbimeve në tregun ndërkombëtar, pasi të jenë shtuar kostot për transport dhe siguracion.

21.2 Kontraktori do të bëjë tendera konkurrues për ndonjë shërbim të kryer, në përputhje me çështjet e përfshira në një program vjetor dhe buxhet, nëse shërbime të tilla priten të kalojnë pesëqind mijë (500 000.00 \$US). Albpetroli mund të ndjekë hapjen e ofertave për të gjithë tenderat e tillë.

## Neni 22

### **Abandonimi**

22.1 Me aprovim të AKBN-së të gjitha pajisjet dhe mjetet (duke përfshirë pusët) e përdorura ekskluzivisht në operacionet hidrokarbure do të abandonohen, në përputhje me praktikën përgjithësisht të pranuar të industrisë ndërkombëtare të naftës. Sidoqoftë, asgjë që përmbahet në këtë Marrëveshje, nuk do ta obligojë Kontraktorin të abandonojë pajisjet dhe mjetet e papërdorura në operacionet hidrokarbure dhe Albpetroli, AKBN-ja dhe Ministria do të mbrojnë, zhdëmtojnë dhe mbajnë Kontraktorin të pacenuar kundrejt kostove dhe pretendimeve, bazuar në detyrime të tilla.

22.2 Kostot e abandonimit do të përfshihen në kostot hidrokarbure. Më qëllim që t'i jepet Kontraktorit mundësi për të rikuperuar kostot e abandonimit, në përputhje me licencëmarrëveshjen, pesë vjet para datës së përcaktuar nga Kontraktori, për të abandonuar të gjitha operacionet hidrokarbure në zonën e projektit (ose në kohë të tilla më të hershme, siç mund të jetë e arsyeshme për të marrë një rikuperim të tillë), kostot e abandonimit të vlerësuara nga Kontraktori dhe koha e rikuperimit të tyre, në përputhje me paragrafin e mëposhtëm të këtij neni 22.2 do të përfshihen në një plan abandonimi dhe t'i dorëzohen AKBN-së për aprovim. AKBN-ja do të shqyrtojë menjëherë vlerësimin e të licencuarit dhe nuk do të kundërshtojë ose vonojë aprovimin e tij në mënyrë të paarsyeshme. Nëse, pas nëntëdhjetë (90) ditësh pas marrjes së vlerësimit të të licencuarit, AKBN-ja dështon, të përcjellë me shkrim komentet tek i licencuari, kostot e vlerësuara të abandonimit të propozuara nga i licencuari, do të gjykohen të aprovuara nga AKBN-ja.

22.3 Me aprovimin e vlerësimit nga AKBN-ja, kostot e vlerësuara të abandonimit do të përfshihen në kostot hidrokarbure dhe do të mbulohen në përputhje me këtë Marrëveshje, në kohën e dhënë në vlerësim. Sidoqoftë, sasi të barabarta me kostot e vlerësuara të abandonimit do të depozitohen në një llogari të palëvizshme duke mbartur interes në një institucion financiar në Londër, Angli i pranueshëm reciprokisht ose në një vend tjetër të tillë, siç mund të bien dakord AKBN-ja dhe Kontraktori. Sapo kostot e abandonimit janë rikuperuar, Kontraktori do t'i tërheqë nga llogaria e palëvizshme kostot e tij të abandonimit. Me përfundimin e abandonimit, çdo fond i tepërt në llogarinë e palëvizshme, pas pagesës së kostove të abandonimit, do të jetë e lirë për Kontraktorin.

## Neni 23

### **Konfidencialiteti**

23.1 Përveç çka specifikohet ndryshe, sipas kësaj Marrëveshjeje, gjithë informacioni i kryer ose i përfituar, ose i marrë sipas kësaj Marrëveshjeje, do të mbahet nga palët konfidenciale në mënyrë strikte, dhe nuk do të bëhet i ditur pa aprovim paraprak me shkrim të palës tjetër, për sa kohë që kjo

Marrëveshje mbetet në fuqi, përveçse në masën e kërkuar për të vepruar në përputhje me ligjet, rregullat dhe rregulloret e ndonjë burse, për të cilën Kontraktori mund të jetë subjekt, po qe se ky informacion nuk bëhet pjesë e sferës publike nëpërmjet burimesh, përveçse Kontraktorit. Për më tepër, Kontraktori do të jetë i lidhur me këto detyrime konfidencialiteti për një periudhë prej pesë (5) vjetësh, në vijim të mbylljes së kësaj Marrëveshjeje.

23.2 Albpetroli dhe Kontraktori mund ta ekspozojë këtë informacion konfidencial te punonjësit e vet, filialet, konsulentët ose nënkontraktorët, në masën e kërkuar për kryerje eficiente të operacioneve hidrokarbure, me kusht që në rastin e ekspozimit te punonjësit, dhe filialet, të sigurojë mbrojtje të mjaftueshme të natyrës së konfidencialitetit të informacionit në fjalë, dhe në rastin e ekspozimit te konsulentët ose nënkontraktorët, me kusht që marrësit e synuar të kenë hyrë fillimisht në një marrëveshje konfidencialiteti.

23.3 Për qëllime të marrjes së ofertave të reja, në pjesë të zonës së kontratës, nga të cilat është hequr dorë ose në zona pranë zonës së kontratës, Albpetroli mund t'i tregojë të dhëna ndonjë entiteti tjetër mbi pjesë të tilla që është hequr dorë, në një formë bazë të pandërprerë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje.

23.4 Në përputhje me marrjen e marrëveshjeve të konfidencialitetit, siç jepet në nenin 23.2 më sipër, cilado palë mund ta ekspozojë këtë informacion të marrë në përputhje me këtë Marrëveshje, siç mund të kërkohet nga institucione financiare, nga të cilët pala që ekspozon është duke kërkuar financim, për qëllime të kryerjes së detyrimeve të tij këtu.

23.5 Në përputhje me një marrëveshje konfidencialiteti, Kontraktori mund të tregojë ndonjë informacion të tillë në mirëbesim (*bona fide*) marrësve potencialë të interesave, të cilët janë të interesuar në të drejtat e naftës, që i janë dhënë Kontraktorit sipas kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 24 Mbyllja

24.1 Kjo Marrëveshje mund të mbyllet nga Kontraktori duke dhënë njoftim me shkrim, jo më pak se nëntëdhjetë (90) ditë tek Albpetroli, me kusht që kjo mbyllje nuk do ta çlirojë Kontraktorin nga ndonjë angazhim i paplotësuar ose detyrim tjetër, sipas kësaj Marrëveshjeje, i rrjedhur para kësaj mbylljeje.

24.2 Kjo Marrëveshje mund të mbyllet nga Albpetroli, duke dhënë njoftim me shkrim te Kontraktori, jo më pak se njëqind e njëzet (120) ditë para dhe në rastet e mëposhtme:

24.2.1 Nëse Kontraktori në mënyrë të përsëritur ka kryer një shkelje materiale të detyrave, dhe detyrimeve të tij themelore, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe është këshilluar nga Albpetroli, me synimin e Albpetrolit për mbylljen e kësaj Marrëveshjeje. Ky njoftim i mbylljes nga Albpetroli do t'i jepet vetëm nëse Kontraktori, me marrjen e njoftimit nga Albpetrol, që ai është në shkelje materiale dhe nuk korrigjon ose nuk është angazhuar të korrigjojë në mënyrë substanciale këtë shkelje, brenda gjashtë (6) muajsh; ose

24.2.2 Nëse Kontraktori, thelbësisht nuk vepron në përputhje me ndonjë vendim përfundimtar, që rezulton nga një procedurë arbitrazhi në përputhje me nenin 19 këtu; ose

24.2.3 Nëse Kontraktori gjykohet i falimentuar nga një gjykatë kompetente ose ka më shumë se një entitet, që përbëjnë Kontraktorin dhe ndonjë prej tyre deklarohet i falimentuar pa entitetet e tjerë ose entiteti merr veprimin e duhur të rregullojë situatën, në lidhje me këtë Marrëveshje.

Mbyllja nga Albpetroli në përputhje me nenin 24.2, nuk do ta lehtësojë kontraktorin nga çdo angazhim të paplotësuar ose detyrime të tjera nën këtë Marrëveshje, që rrjedhin para një përfundimi të tillë, duke përfshirë pa kufizim pagesat e detyrimeve monetare për angazhimet e punës të paplotësuar, riparimet sipërfaqësore, përmirësimet e mjedisit dhe abandonimin.

24.3 Përsa i përket mbylljes para afatit, në pajtim me nenin 24.1 ose 24.2, kjo Marrëveshje do të përfundojë automatikisht në tërësinë e saj, nëse nga e gjithë zona e kontratës është hequr dorë ose periudha e zhvillimit dhe e prodhimit, ose ndonjë zgjatje e mëtejshme ka përfunduar, në përputhje me nenin 3.4 dhe 3.7.



## Neni 25

### **Auditet**

Albpetroli do të ketë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajsh, nga marrja e secilës deklarate të llogarisë kostot, në përputhje me procedurën llogaritëse, në të cilën për të audituar dhe ngritur objeksione, përta i përket ndonjë deklaratë të tillë të llogarisë kosto, me kusht që Albpetroli nuk do të titullohet të kryej më shumë se dy audite të librave të llogarisë, regjistrimeve dhe llogarive në një vit fiskal. Albpetroli dhe Kontraktori do të bien dakord për çdo rregullim të kërkuar. Dokumente shtesë dhe llogaritë do të bëhen të disponueshme për Albpetrolin, gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë. Nëse brenda kohës kufi të periudhës tre (3) mujore, në vijim të kalimit të periudhës së mësipërme, prej dymbëdhjetë (12) muajsh, Albpetroli nuk ka këshilluar Kontraktorin me kundërshtimin e tij për këtë deklaratë, kjo deklaratë do të konsiderohet e aprovuar.

## Neni 26

### **Klauzola e përgjithshme**

#### 26.1 Njoftimet

a) Njoftimet dhe komunikimet e tjera të kërkuara ose të lejuara për t'u dhënë, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të gjykojnë të dhëna, kur janë dërguar dhe marrë me shkrim ose me dorë ose nëpërmjet postës, ose me transmetim me faks, në adresat e dhëna si më poshtë:

Për Albpetrolin:  
Lagja "29 Marsi", Patos-Albania  
Tel: 00 355 381 22 52  
Fax: 00 355 381 41 68  
Për dijeni: Drejtorit ekzekutiv

*Për Kontraktorin:*  
Sherwood International Petroleum, Ltd.  
1900, 555\_ 4<sup>th</sup> Avenue S.W.,  
Calgary, Alberta, T2P 3E7  
Canada  
Për dijeni: Geoffrey Carrington, President & CEO  
Tel: +1 (403) 875-9398  
Fax: +1 (403) 263-9659  
Email: Gcarrington @sherwoodpetroleum.com  
Kopje zyrës së Sherwood në Shqipëri në vëmendje të: Menaxherit vendas

Albpetroli dhe Kontraktori mund të ndryshojnë adresën ose adresat e tyre, duke dhënë njoftim për këtë ndryshim te njëri-tjetri.

b) Njoftimet e dhëna nga Albpetroli te Kontraktori do të gjykojnë të dhëna, nëse jepen në zyrën e Kontraktorit në Tiranë.

#### 26.2 Përgjegjësia

26.2.1 Kontraktori nuk do të jetë përgjegjës ndaj Albpetrolit me përjashtim kur, personeli supervizues i lartë i Kontraktorit është neglizhues plotësisht në kryerjen e operacioneve hidrokarbure.

26.2.2 Në asnjë rrethanë Kontraktori nuk do të jetë përgjegjës për dëmtime të tilla pasuese, ose indirekte të tilla si humbje të fitimit, ose humbje të prodhimit.

26.2.3 Në rast të ndonjë dëmtimi, për të cilën Kontraktori bëhet përgjegjës në përputhje me nenin 26.2.1, Kontraktori do të përpiqet, që në mënyrë të menjëhershme dhe të zellshme, të marrë të gjitha masat e nevojshme, në përputhje me praktikën ndërkombëtare të industrisë së naftës, të zbusë dëmin dhe të rivendosë operacione normale. Kontraktori do të paguajë dëmshpërblim kompensues për atë, për të cilën ai është deklaruar përfundimisht përgjegjës.

26.2.4 Kontraktori do të mbajë të pacenuar Qeverinë Shqiptare, Albpetrolin dhe punonjësit,

nëpunësit, drejtorët dhe agjentët respektivë të tyre për të gjitha pretendimet nga palë të treta, për dëmtime personale ose dëmtime pasurie, që rrjedhin nga performanca e operacioneve hidrokarbure të kryera nga dhe në emër të Kontraktorit, duke përfshirë pa kufizim, pagesa të arsyeshme të avokatit dhe kostot e mbrojtjes, me kusht që Kontraktori nuk do të mbahet përgjegjës sipas këtij neni 26.2.4 për çdo humbje, pretendim, dëmtim ose plagosje të shkaktuar nga, ose që rezulton nga ndonjë veprim neglizhues i Qeverisë Shqiptare, Albpetroli dhe punonjësit, zyrtarët, drejtorët dhe agjentët respektivë të tyre.

#### 26.3 Sigurimi

Kontraktori, si pjesë e operacioneve hidrokarbure do të mbajë siguracion me një operator të arsyeshëm dhe me zë në industrinë e naftës, siguracion që do të mbahet në lidhje me operacionet e tij.

#### 26.4 Gjuha e tekstit

Kjo Marrëveshje është bërë dhe ka hyrë si në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Në rast të një konflikti ndërmjet versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

#### 26.5 Efektiviteti

Kjo Marrëveshje është ligjore dhe detyruese në dhe prej datës efektive.

#### 26.6 E gjithë Marrëveshja

Kjo Marrëveshje (së bashku me çdo dokument të referuar brenda në të) përbën gjithë marrëveshjen ndërmjet palëve dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme mirëkuptimi, rregullimi, ripërfaqësimi, marrje përsipër dhe garanci ndërmjet palëve, në lidhje me çështjen në fjalë të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë pa kufizim termat e tenderimit për zonën e kontratës, dorëzuar AKBN-së.

#### 26.7 Garancia bankare

Kontraktori zotohet të sjellë një garanci bankare për programin e vlerësimit, në formën e dhënë në aneksin C. Kontraktori dhe Albpetroli bien dakord, që garancia bankare duhet të merret nga AKBN (60) gjashtëdhjetë ditë pas aprovimit të kësaj Marrëveshjeje nga Këshilli i Ministrave.

#### 26.8 Anekset

Anekset A, B, C, D, E dhe F, bëhen këtu një pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje dhe do të konsiderohen sikur kanë të njëjtën fuqi dhe efekt me klauzolat e pjesës kryesore të kësaj.

Marrëveshje. Sidoqoftë, në rast të ndonjë konflikti ndërmjet pjesës kryesore dhe ndonjë aneksi, klauzolat e pjesës kryesore do të mbizotërojnë.

#### 26.9 Variacione

Variacione të kësaj Marrëveshjeje nuk do të jenë efektive, po qe se nuk bëhen me shkrim dhe të firmosura nga palët.

#### 26.10 Heqje dore

Dështimi i ndonjë pale për të ushtruar ose imponuar ndonjë të drejte, në lidhje me këtë Marrëveshje, nuk do të ose do të gjykohet një heqje dore prej ndonjë të drejte të tillë.

#### 26.11 Imunitet i pavarur

Çdo palë që tani dhe më vonë, ka një të drejtë të pretendojë për imunitet të pavarur për vete ose ndonjë aset të tij, prandaj heq dorë nga një imunitet i tillë në masën më të plotë të lejuar me ligj ose ndonjë juridiksion i aplikueshëm. Kjo heqje dorë përfshin imunitetin nga: (i) ndonjë përcaktim ekspertit, ndërmjetësim ose procedim arbitrazhi, të filluar në përputhje me këtë Marrëveshje; (ii) ndonjë procedurë juridike, administrative ose tjetër për të ndihmuar përcaktimin e ekspertit, ndërmjetësimin ose arbitrazhin e filluar në përputhje me këtë Marrëveshje; dhe (iii) ndonjë përpjekje për të konfirmuar, imponuar ose ekzekutuar ndonjë vendim, zgjidhje, vendim gjyqi, gjykim, shërbim procesi, ekzekutim urdhri ose pjese (duke përfshirë pjesë para gjykimit) që rezulton nga një përcaktim ekspertit, ndërmjetësim, arbitrazh ose çdo procedurë juridike ose administrative të filluar në përputhje me këtë Marrëveshje. Çdo palë pranon që të drejtat dhe detyrimet e tij këtu janë të një natyre komerciale dhe joqeveritare.

#### 26.12 Autoriteti

Secili entitet, i cili është një nënshkrues në këtë Marrëveshje, garanton tjetrit, që ai ka fuqi dhe autoritet të plotë, për të hyrë në këtë Marrëveshje dhe që kjo Marrëveshje përbën një detyrim ligjor të vlefshëm dhe detyrues ndaj saj.

**Bonuset e trajnimit dhe të firmosjes**

27.1 Sherwood do t'i paguajë Albpetrolit një bonus firmosjeje prej 50 000 US \$, pas nënshkrimit të Marrëveshjes hidrokarbure (MH), për vendburimin e Koçovës dhe marrjes së gjithë aprovimeve të nevojshme qeveritare dhe rregullatore të Marrëveshjes hidrokarbure (MH); dhe:

Sherwood do të shpenzojë për punonjësit e Albpetrolit 50 000 US \$ për çdo vit kontraktual, në përputhje me bonusin e trajnimit vjetor (BTV), pas sigurimit të aprovimit të MH për vendburimin, Kuçovë nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Shuma prej 50 000 US \$, si bonus firmosjeje, nuk do të jetë e rikuperueshme.

Me dëshmi këtu, palët hyjnë në këtë Marrëveshje në datën e shkruar më sipër.

Albpetroli

Nga: Ylli Gjoni

Titulli: Drejtor i përgjithshëm

Firmosur: \_\_\_\_\_

Kontraktori

Nga: Geoffrey Carrington


Titulli: \_\_\_\_\_

Firmosur: \_\_\_\_\_

## ANEKSI A ZONA E KONTRATES:

Koordinatat:

Gauss-Kruger			UTM WGS 1984, Zone 34 North, Merid. Cent. 21d E	
Nr	X	Y	X	Y
1	45 22 600	44 02 550	45 20 711.047	4 02 590.609
2	45 24 300	44 04 350	45 22 410.337	4 04 389.859
3	45 24 900	44 11 950	45 23 010.087	4 11 986.692
4	45 22 000	44 11 000	45 20 111.297	4 11 037.088
5	45 18 000	44 09 000	45 16 112.966	4 09 037.922
6	45 17 200	44 05 250	45 15 313.300	4 05 289.484
7	45 16 200	44 04 100	45 14 313.717	4 04 139.964
8	45 17 650	44 03 150	45 15 763.112	4 03 190.359



## ANEKSI B PROCEDURA LLOGARITËSE

### Klauzolat e përgjithshme

Kjo procedurë llogaritëse aplikohet dhe do të mbahet për krijimin, mbajtjen dhe kontrollin e të gjitha llogarive, librave të llogarive dhe regjistrimeve, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Marrëveshja dhe procedura llogaritëse synohen të jenë korelative dhe me shpjegim reciprok. Sidoqoftë, nëse lind ndonjë mospërputhje, atëherë klauzolat e Marrëveshjes do të mbizotërojnë.

### Neni 1

#### 1.1 Përkufizimet

1.1.1 Termat e përdorur në këtë procedurë llogaritëse kanë të njëjtat kuptime siç jepen për të njëjtat terma në Marrëveshjeje.

1.1.2 “Material i kontrollueshëm” do të thotë material, të cilin Kontraktori, në përputhje me regjistrimin, e kontrollon dhe e inventarizon, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare të industrisë së naftës.

1.1.3 “Material” do të thotë çdo pajisje, makineri, materialet, artikujt, furnizimet dhe të konsumueshmet, të cilat ose janë blerë, ose janë marrë me qira, ose janë të transferuara nga Kontraktori dhe të përdorura në operacionet hidrokarbure.

#### 1.2 Librat e llogarive dhe regjistrimet

Librat e llogarive dhe regjistrimet e llogarive, duke përfshirë dokumentet për taksën, do të mbahen në përputhje me principet llogaritëse përgjithësisht të pranuar dhe të njohura që është në përputhje me ligjin shqiptar dhe sipas procedurave dhe praktikave moderne të industrisë së naftës, në masën që këto praktika dhe procedura nuk konfliktojnë me ligjin shqiptar. Librat e llogarive dhe regjistrimet do të jenë në gjuhën angleze dhe \$US.

#### 1.3 Rishikim i procedurës llogaritëse

Me marrëveshje reciproke ndërmjet Albpetrolit dhe Kontraktorit, kjo procedurë llogaritëse mund të rishikohet herë pas here, nën dritën e rregullimeve në të ardhmen.

### Neni 2

## **Kostot hidrokarbure**

#### 2.1 Kostot hidrokarbure

Kontraktori do të mbajë një llogari kostoje, në të cilën do të reflektohen të gjitha kostot hidrokarbure.

Këto kosto hidrokarbure do të përdoren për llogaritjen e pjesës së Albpetrolit, sipas nenit 9. Pa kufizuar të përgjithshmen, çka përmendet më sipër, kostot dhe shpenzimet e shqyrtuara në aneksin B, nenet 2.2 deri 2.2.3, këtu më poshtë, janë përfshirë në kostot hidrokarbure. Kostot hidrokarbure, duke përfshirë të gjitha ato të akumuluar, para aprovimit të planit të zhvillimit të parë do të përfshihen tërësisht pa amortizim, duke filluar në tremujorin kalendarik në të cilën këto kosto janë kryer. Është e kuptueshme që as pjesa e Albpetrolit, dhe as prodhimi i gjykuar nuk do të trajtohen si kosto hidrokarbure, por kostot e Kontraktorit për nxjerrjen dhe dorëzimin tek Albpetroli të pjesës së Albpetrolit dhe prodhimit të gjykuar, janë kosto hidrokarbure.

#### 2.2 Kostot e punës dhe që lidhen me atë

2.2.1 Kostot aktuale të të gjithë punonjësve të Kontraktorit dhe kostot e personelit të emëruar ose përkohësisht të emëruar, ose të marrë me qira te Kontraktori. Këto kosto do të përfshijnë, por pa u kufizuar në:

- a) pagat bruto dhe shpërblimet ose pagat;
- b) kostoja për orë shtesë, festa, pushime, sëmundje, përfitime për paaftësi dhe lejeve të tjera të aplikueshme ndaj pagave të pagueshme, sipas (a) këtu;
- c) shpenzime, taksa dhe pagesa të tjera, nëse ka ndonjë të bëra në përputhje me vlerësimet ose detyrimet e taksuara nga autoritete ministeriale, të cilat janë të aplikueshme ndaj koston së pagave të pagueshme, sipas (a) këtu;
- d) koston e skemave të ngritura për sigurimin e jetës së punonjësve, trajtim spitalor, pensione,

skemat për kursime dhe përfitime të tjera të të njëjtës natyrë të aplikueshme ndaj pagave të pagueshme, sipas (a) këtu;

e) kostot për transport dhe rivendosje dhe kostot e transportit të punonjësve, të familjeve të këtyre punonjësve (e kufizuar te gruaja dhe fëmijët në ngarkim) dhe shtëpinë si të ligjshme ose të zakonshme për Kontraktorin;

f) të gjitha kostot e udhëtimit dhe rivendosjes së punonjësve, dhe familjeve të tyre në, dhe nga vendi i punonjësit ose vendi i origjinës, gjatë kohës së punësimit;

g) kosto e akomodimit për punonjësit;

h) shpërblime, kohë shtese, leje të zakonshme dhe përfitimet, të cilat do të jenë të aplikueshme ndaj punonjësve vendas në Republikën e Shqipërisë, të gjitha si të pagueshme, sipas (a) këtu;

2.3 Shpenzimet për kualifikimin e punonjësve

Kostot e kualifikimit për punonjësit e Kontraktorit ose të emëruar, ose të emëruar përkohësisht, ose të marrë me qira nga Kontraktori.

2.4 Materialet

Kostoja e materialeve do të ngarkohet në llogarinë e kostove mbi bazën e parashtuar më poshtë. Kontraktori nuk garanton materialin. Të vetmet garanci, janë garancitë e dhëna nga prodhuesit ose shitësit, për aq kohë sa janë në fuqi.

2.4.1.1 Përveç çka jepet ndryshe në pjesën 2.4.1.2 më poshtë, materiali do të ngarkohet në koston neto aktuale të kryer nga Kontraktori sipas faturës së çmimit të shitësit, paketimit, transportimit, shpenzimeve të ngarkimit dhe shkarkimit kostot e sigurimit, taksat doganore, pagesave dhe taksave të aplikueshme, nëse ka ndonjë, duke zbritur të gjitha uljet e marra aktualisht.

2.4.1.2 Materiali i furnizuar nga Kontraktori, nga magazinat e tij, do të ngarkohet me çmimet e specifikuar këtu më poshtë:

a) Materiali i ri (Kondicioni "A") do të vlerësohet me koston neto aktuale ndërkombëtare, e cila nuk do të kalojë çmimin mbizotërues në transaksionet normale, në përputhje me tregun e hapur (arm's length transactions);

b) Materiali i përdorur (Kondicionet "B", "C" dhe "D") dhe materiali pa vlerë:

i) Materiali, i cili është në kondicion të mirë dhe i riparueshëm dhe është i përshtatshëm për ripërdorim parikondicionim, do të klasifikohet si kondicion "B" dhe do të vlerësohet me shtatëdhjetë e pesë për qind (75%) të çmimit aktual të një materiali të ri të përcaktuar në (a), më sipër.

ii) Materiali, i cili nuk mund të klasifikohet si i kondicionit "B", por i cili pas rikondicionimit do të jetë për përdorim të mëtejshëm të funksionit të tij fillestar, do të klasifikohet si kondicion "C" dhe i vlerësuar me pesëdhjetë (50%) të çmimit aktual të materialit të ri të përcaktuar në (a), më sipër. Kostoja e rikondicionimit do të ngarkohet te materiali i kondicionuar me kusht që vlera e materialit kondicion "C" plus koston e rikondicionimit, nuk do të kalojë vlerën e materialit kondicion "B".

iii) Materiali, i cili ka akoma një vlerë, por nuk mund të përdoret në funksionin e tij fillestar dhe që prandaj nuk mund të klasifikohet kondicion "B" ose kondicion "C", do të klasifikohet si kondicion "D", dhe do të vlerësohet me një vlerë të krahasuar me përdorimin e tij.

iv) Materiali, i cili është i përdorshëm, por që nuk mund të klasifikohet si kondicion "B" ose kondicion "C", ose kondicion "D", do të klasifikohet si mbeturinë dhe do të konsiderohet sikur nuk ka vlerë.

2.4.2 Inventaret

Në intervale të arsyeshme, të paktën çdo vit, do të bëhen nga Kontraktori inventare për të gjitha materialet e kontrollueshme dhe në vijim të çdo inventari do të rregullohen librat e llogarive dhe regjistrimet për të reflektuar rezultatet e inventarit. Kontraktori do të njoftojë me shkrim tridhjetë (30) ditë para, për qëllim të inventareve të tilla për të lejuar Albpetrolin për të zgjedhur, nëse do të përfaqësohet apo nuk do të përfaqësohet, kur të kryhet inventari.

2.5 Shpenzimet indirekte

Administrative dhe mjediseve të punës të tilla si bazë në breg të detit, magazina, sisteme uji, sisteme rrugësh, pagat dhe shpenzimet e personelit supervizues të vendburimit, nëpunësve në vendburim, asistentëve dhe punonjësit e tjerë të përgjithshëm, që punojnë në zonën e projektit.

Pagesat për komisionet dhe marketingun ose komisioner në lidhje me shitjen e naftës.

2.6 Transportimi

Transportimi i materialeve dhe kostot e tjera, që lidhen me ato, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në shërbimet në origjinë, dërgimi, vendosjen në kontenier, pagesat në dok, pagesat për

dërguesit, transportin detar dhe tokësor dhe pagesat për taksat doganore dhe shërbime me destinacion tjetër. Transportimin e naftës deri te pika e livrimit përkatës duke përfshirë pa kufizim pagesat për tubacione (si fikse dhe variabël) dhe kostot e transportit me autobus.

## 2.7 Shërbimet

2.7.1 Koston aktuale të kontratës së shërbimit, konsulentët profesionistë dhe shërbime të tjera të kryera nga palë të treta.

2.7.2 Kostot e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë për përfitim direkt të operacioneve hidrokarbure të furnizuara nga Kontraktori ose kompanitë e afiliuara të tij, ose palë të treta me tarifa të krahasueshme, me koston e pronësisë ose të marrjes me qira dhe koston e operimit të saj.

## 2.8 Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative në Republikën e Shqipërisë

Ndërkohë që Kontraktori kryen aktivitete sipas Marrëveshjes, kostot e stafit dhe mbajtjes së zyrave qendrore të Kontraktorit në Republikën e Shqipërisë dhe/ose zyrave të tjera të ngritura në Republikën e Shqipërisë, do të ngarkohen me kostot hidrokarbure.

Në rast se ky personel dhe kosto të zyrave të Kontraktorit ose filialeve të Kontraktorit, nuk i atribuohen plotësisht operacioneve hidrokarbure, atëherë këto kosto do të ngarkohen mbi një bazë të barabartë.

Kostot e udhëtimit dhe akomodimit, në lidhje me mbledhjet e Komitetit këshillimor, do të ngarkohen me kostot hidrokarbure, pavarësisht se këto takime mbahen brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

## 2.9 Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative të kompanisë mëmë të Kontraktorit, jashtë Republikës së Shqipërisë, të aplikueshme ndaj operacioneve, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të ngarkohen çdo vit në masën 5% të buxhetit total të çdo viti.

## 2.10 Taksat

Të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera që paguhet në Republikën e Shqipërisë nga Kontraktori, në lidhje me këtë Marrëveshje, përveç atyre të mbuluara nga neni 13.1 i Marrëveshjes, nëse ka ndonjë.

## 2.11 Të drejtat për përdorimin e tokës

Të gjitha kostot direkt që kanë të bëjnë me marrjen në përdorim, rinovim ose heqje dore prej të drejtave për përdorim të tokës, të marra dhe të mbajtura në fuqi për zonën.

## 2.12 Dëmtimet dhe humbjet e materialeve dhe pajisjeve

Në përputhje me nenin 26.2 të Marrëveshjes të gjitha kostot ose shpenzimet e nevojshme për riparimin dhe zëvendësimin e materialeve ose pajisjeve, që rezultojnë nga dëmtimet ose humbjet e ndodhura nga zjarri, përmytja, stuhia, vjedhja, aksidentet ose për ndonjë arsye tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të Kontraktorit.

## 2.13 Sigurimet dhe pretendimet

2.13.1 Pagesat e bëra për sigurim, për të mbuluar risqet, në lidhje me operacionet hidrokarbure në përputhje me praktikën e Kontraktorit ose ndonjë prej punonjësve të tij dhe/ose i huaj, e cila është në përputhje me praktikën ndërkombëtare të industrisë së naftës, ose që kërkohet me ligj.

2.13.2 Në përputhje me nenin 26.2 të Marrëveshjes, shpenzimet aktuale të kryera për zgjidhjen e të gjitha humbjeve, pretendimeve, dëmtimeve, gjykimeve dhe shpenzimeve të tjera (duke përfshirë shpenzimet ligjore siç jepen më poshtë) në dobi të operacioneve hidrokarbure.

## 2.14 Shpenzimet ligjore

Të gjitha kostot ose shpenzimet e shërbimeve gjyqësore, ose ligjore për të mbrojtur interesin e Kontraktorit në zonën e kontratës sipas, ose në përputhje me Marrëveshjen dhe siç mund të nevojiten, ose mjeti duke përfshirë, por pa u kufizuar në pagesat e konsultave ligjore, kostot e arbitrazhit, kostot e gjyqit, koston e investigimit ose prokurimit ndaj dëshmisë, dhe sasi të paguara në zgjidhjen ose përmbushjen e ndonjë gjykimi të tillë, ose pretendimeve. Këto shërbime mund të kryhen nga stafi ligjor i Kontraktorit dhe/ose një firmë e huaj, siç mund të jetë e nevojshme, me kusht që këto kosto nuk kanë rrjedhur nga konfliktet e pasuksesshme të Kontraktorit me Albpetrolin.

## 2.15 Pagesat dhe tarifat

Të gjitha pagesat dhe kuotat, të cilat janë paguar nga Kontraktori në lidhje me këtë Marrëveshje.

## 2.16 Zyrat, kampet dhe mjediset e ndryshme

Kostoja e ngritjes, mirëmbajtjes dhe operimit të çdo zyre, nënzyre, kampeve, magazinave, shtëpi banimi dhe mjedise të tjera, të tilla si mjedise për shlodhje për punonjësit. Nëse këto mjedise shërbejnë për më shumë se një (1) zonë kontrate, atëherë do të alokohen mbi një bazë të barabartë.

#### 2.17 Shpenzime për marrëveshje shërbimi

Shpenzimet, sipas ndonjë marrëveshjeje shërbimi, të bëra ndërmjet Kontraktorit ose ndonjë prej kompanive të afiliuara të tij.

#### 2.18 Mjedisi

Kostot e kryera për ndonjë prej operacioneve të parashikuara në nenin 20.

#### 2.19 Abandonimi

Kostot e kryera ose sasia e faturuar, në përputhje me nenin 22.

#### 2.20 Shpenzime të tjera

Në përputhje me aprovimin e Albpetrolit, i cili nuk do të kundërshtohet në mënyrë të paarsyeshme, çdo shpenzim i arsyeshëm që nuk mbulohet ose trajtohet në klauzolat e mëparshme, të cilat janë kryer nga Kontraktori për nevojë dhe performancë të duhur të operacioneve hidrokarbure dhe kryerjen e detyrimeve të tij, sipas Marrëveshjes ose që lidhet me atë.

#### 2.21 Humbjet ose fitimi në monedhë

Humbjet e monedhës në përdorim të kryera nga Kontraktori do të ngarkohen në kostot hidrokarbure dhe fitimet në përdorim të monedhës të kryera nga Kontraktori do të kreditohen në kostot hidrokarbure.

#### 2.22 Kreditimet sipas kontratës

Të ardhurat neto të transaksioneve të mëposhtme do të kreditohen në llogaritë sipas kontratës:

a) të ardhurat neto të ndonjë sigurimi, nëse siguracioni është i rikuperueshëm si kosto ose pretendim në lidhje me operacionet hidrokarbure ose ndonjë aset i ngarkuar në llogari sipas kontratës;

b) e ardhura e marrë nga të huaj për përdorim të pasurisë ose aseteve të ngarkuara në llogari, sipas Marrëveshjes, e cila është bërë e tepërt në operacionet hidrokarbure dhe është marrë me qira, ose shitur;

c) çdo rregullim i marrë nga Kontraktori, nga furnizuesit/prodhuesit ose agentët e tij në lidhje me pajisje, ose materiale të defektuara, kostoja e të cilave është ngarkuar më parë nga Kontraktori sipas kontratës;

d) rentat, financimet ose kreditime të tjera të marra nga Kontraktori, të cilat aplikohen ndaj çdo pagese, e cila është bërë në llogari sipas kontratës;

e) të ardhurat nga të gjitha shitjet e materialeve të tepërta ngarkuar në llogari, sipas Marrëveshjes, në llogarinë neto aktuale të mbledhur.

#### 2.23 Nuk lejohet dublikim i pagesave dhe kreditimeve

Pavarësisht ndonjë klauzole në kundërshtim me këtë procedurë llogaritëse, synimi është që nuk do të ketë dublikim të pagesave ose kreditimeve në llogaritë sipas Marrëveshjes.

### Neni 3

#### **Të ardhurat e Kontraktorit**

3.1 Të ardhurat e Kontraktorit do të përcaktohen mbi një monedhë, bazuar në shitjet në pikën e livrimit. Kostot, para pikës së livrimit, përfshihen në kostot e operacioneve hidrokarbure, sipas nenit 2, më sipër.

### Neni 4

#### **Raportet financiare që dorëzohen tek Albpetroli**

4.1 Detyrimi raportues i dhënë në këtë pjesë do të aplikohet ndaj Kontraktorit dhe do të jetë në mënyrën e treguar këtu më poshtë.

4.2 Kontraktori do të dorëzojë tek Albpetroli brenda dyzet e pesë (45) ditëve nga fundi i çdo tremujori kalendarik:

4.2.1 Një raport të shpenzimeve dhe të faturave, sipas Marrëveshjes, të analizuara me buxhetin duke treguar:

a) shpenzimet aktuale dhe faturat për tremujorin kalendarik në diskutim;

b) shpenzimet aktuale kumulative në atë datë;

c) ndryshimet ndërmjet shpenzimeve të buxhetuara, dhe shpenzimeve aktuale, dhe shpjegimet



e tyre.

4.2.2 Një deklaratë të kostos, e cila përmban informacionin e mëposhtëm:

a) kostot e operacioneve hidrokarbure të mbartura nga tremujori kalendarik i mëparshëm, nëse ka ndonjë të tillë;

b) kostot e operacioneve hidrokarbure të kryera gjatë tremujorit kalendarik;

c) kostot totale të operacioneve hidrokarbure për tremujorin kalendarik (a) plus (b), më sipër;

d) sasinë e naftës së prodhuar për tremujorin kalendarik, sasinë e naftës të shitur për tremujorin kalendarik dhe sasinë e të ardhurave të Kontraktorit për tremujorin kalendarik; dhe

e) llogaritjen e faktorit F për tremujorin kalendarik; dhe

f) sasinë e kostove hidrokarbure për t'u mbartur në tremujorin kalendarik tjetër, nëse ka ndonjë.

4.3 Pas fillimit të prodhimit, Kontraktori brenda tridhjetë (30) ditësh, pas përfundimit të secilit tremujor kalendarik, do t'i dorëzojë Albpetrolit një raport prodhimi, ku tregohet sasia e naftës për zonën e zhvillimit dhe prodhimit e shprehur në ton, metër kub dhe barrele:

a) mbajtur në stok në fillim të muajit;

b) prodhuar gjatë muajit;

c) marrë dhe nga kush;

d) humbur dhe konsumuar në operacionet hidrokarbure; dhe

e) mbajtur në stok në fund të muajit.

### ANEKSI C FORMË E GARANCISË BANKARE DREJTUAR AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE

Ne jemi informuar se Sherwood International Petroleum, Ltd ka nënshkruar një Marrëveshje Hidrokarbure për vendburimin e naftës, Kuçovë me kompaninë Albpetrol sh.a., efektive prej datës \_\_\_\_\_ (këtu e më poshtë MH) dhe kuptojmë që me parashikimet e MH-së kërkohet një garanci bankare.

Ne, gjithashtu jemi informuar se në përputhje me termat e MH-së, Sherwood International Petroleum, Ltd ka ndërmarrë për periudhën e vlerësimit një program pune në zonën e kontratës (siç përshkruhet në MH) dhe duke shpenzuar një shumë prej një milion e pesë qind mijë (1 500 000) USD.

Sipas kërkesës së Sherwood International Petroleum, Ltd, në \_\_\_\_\_ (emri dhe adresa e bankës) këtu garantojnë të ndërmarrin për t'u paguar juve ndonjë shumë ose shuma që nuk kalojnë shumën në USD një milion e pesë qind mijë (1 500 000) US\$, pasi të kemi marrë nga ju kërkesën e parë të bërë në përputhje me procedurën e kërkesës së detajuar, si më poshtë:

Kërkesa juaj duhet të paraqitet nga një letër dhe duhet të shoqërohet nga:

- Një kopje e njoftimit tuaj drejtuar Sherwood International Petroleum, Ltd (e datuar të paktën tridhjetë (30) ditë para datës së kërkesës tuaj) duke informuar Sherwood International Petroleum, Ltd për një thyerje të detyrimeve të tij në programin e punës sipas MH, natyrën dhe sasinë e thyerjeve dhe qëllimi juaj për kërkesën e pagesës sipas kësaj garancie, nëse thyerja nuk është kryer brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e njoftimit tuaj; dhe

- Deklarimi juaj i nënshkruar duke thënë se Sherwood International Petroleum, Ltd nuk ka mundur të rregullojë thyerjen e detajuar në njoftimin tuaj nga data e specifikuar.

Ndonjë kërkesë këtu dhe dokumentet e specifikuar më sipër duhet të merren nga ne në adresën tuaj të mësipërme, në përputhje me procedurën e kërkesave të sipërpërmendura në ose para datës së mbarimit të kësaj garancie, siç përshkruhet më poshtë, pas së cilës datë kjo garanci nuk do të ketë më asnjë efekt.

Një kërkesë e paraqitur me faksimile nuk është e pranueshme.

Kjo garanci do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës efektive të Marrëveshjes hidrokarbure dhe do të mbetet e vlefshme:

1. Për periudhën e vlerësimit: Para gjashtë (6) muajve pas mbarimit të fazës së vlerësimit; dhe (b) datës kur shuma totale e kësaj garancie është tërhequr ose reduktuar, siç thuhet në paragrafin e mëposhtëm.

Shuma e kësaj garancie do të reduktohet çdo tremujor gjatë periudhës së vlerësimit me një

shumë të barabartë me shumën e shpenzuar nga Sherwood International Petroleum, Ltd në detyrimet e programit të tij të punës gjatë këtij tremujori, reduktime të tilla do të jenë efektive në përputhje me deklarinimin me shkrim tremujor të kryer nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për Sherwood International Petroleum, Ltd.

Kjo garanci është personale për ju dhe nuk është e transferueshme ose nuk mund t'i jepet askujt tjetri, (përveç pëlqimit tonë me shkrim, i cili nuk do të kundërshtohet në mënyrë të paarsyeshme).

Kjo garanci është subjekt i rregullave uniforme për kërkesëgarancitë, publikimet ICC nr.458 dhe për më tepër joinkonsistent me këtë, do të administrohet dhe ndërtohet në përputhje me ligjin (vendas) \_\_\_\_\_, vendi i juridiksionit është \_\_\_\_\_(vendi), \_\_\_\_\_ (shteti).

## ANEKSI D PROGRAMI I VLERËSIMIT

1. Faza e vlerësimit do të zgjasë 24 muaj (njëzet e katër) (shiko komentet e mëparshme të nenit 3.2), nga data efektive me mundësi zgjatjeje prej 6 muajsh, sipas kërkesës me shkrim të Kontraktorit dhe Albpetrolit drejtuar AKBN-së.

2. Riaktivizimi ose rikompletimi i 10 (dhjetë) puseve në vendburimin, Kuçovë. Kontraktori do të hyjë dhe pastrojë trungjet e puseve ekzistuese dhe ta rregulloj tubingun e prodhimit sipas nevojës. Kjo nënkupton, që pompat e reja të tipit me kavitetet progresive do të vendosen në trungun e pusit tamam të një kapaciteti të tillë, sipas aftësisë produktive të pusit. Pompat do të lidhen me pajisje gjeneratori të vogël, i cili do të aktivizohet në qoftë se energjia elektrike, që furnizon pompat ndërpritet për ndonjë arsye, kështu që do të sigurohet 24 orë punë të pompës. Puna që duhet të bëhet në çdo pus do të jetë në gjykimin e vetëm të Kontraktorit.

3. Të pajisë dhe të fusë në rrjetin e prodhimit 10 (dhjetë) puse, që aktualisht nuk japin prodhim, por që janë të aftë të prodhojnë. Përveç kësaj, për punën e përmendur më sipër, këto puse do të riaktivizohen, pasi të jetë vlerësuar i gjithë informacioni në dispozicion për çdo pus dhe pasi gjykohe të jetë kandidat i përshtatshëm për aktivizim. Riaktivizimi i pusit mund të përfshijë izolimin e zonave të preferuara, që nuk prodhojnë më naftë, dhe ripërformimin e horizonteve produktive ekzistuese dhe/ose perforimin e zonave të reja të gjykuara të afta, që të prodhojnë naftë. Puna që do të bëhet në çdo pus do të jetë në gjykimin e vetëm të Kontraktorit.

4. Të vlerësojë prodhimin, rezervat dhe performancën e rezervuarit të vendburimit, Kuçovë dhe të përgatisë një raport inxhinierik.

5. Të rishikojë dhe të raportojë mbi aplikimin e teknologjisë së kontrollit të rërës.

6. Të rishikojë konservimin e gazit dhe përdorimin brenda planit të zhvillimit.

7. Testime të prodhimit dhe/ose të presionit të puseve të zgjedhura.

8. Të realizojë një rishikim të certifikimit të rezervave ekzistuese.

9. Të rrisë kapacitetin e injektimit të ujit, duke shtuar një pus injektimi shtesë, nëse është e nevojshme.

10. Vlerësimi i infrastrukturës ekzistuese, dhe në të ardhmen, për zhvillimin dhe komercializimin e prodhimit nga vendburimi, Kuçovë, për tregjet e brendshme dhe eksporte të mundshme.

11. Të përfundojë një plan zhvillimi për vendburimin, Kuçovë, për fazën e zhvillimit dhe prodhimit.

12. Kontraktori angazhohet të shpenzojë të paktën 1 500 000 \$US në shpenzime kapitale (shiko komentet e mëparshme neni 3.2) gjatë 24 muajve të parë, pas datës efektive, në drejtimin e programit të vlerësimit.

## ANEKSI E INSTRUMENTI I TRANSFERIMIT KY INSTRUMENT I TRANSFERIMIT ËSHTË BËRË, MË 4.9. 2007

Ndërmjet:

1. Albpetrol sh.a. "Albpetrol"; një Kompani shqiptare, zyrat qendrore të të cilit janë në Patos, Shqipëri;

2. Sherwood International Petroleum, Ltd. "Kontraktor", Alberta kompani kanadeze, me një degë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë; dhe

3. AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE "AKBN", një entitet ligjor i autorizuar me vendim nr.547, datë 9.8.2006 të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Ndërsa:

Albpetroli është një palë në një licencëmarrëveshje, të bërë me datën 7.6.2007 me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar nga AKBN-ja dhe Sherwood International Petroleum, Ltd dëshiron të bashkohet me Albpetrolin, në kryerjen e operacioneve hidrokarbure (siç përcaktohet atje).

Tani ky instrument dëshmon që për shkak të dhe në përputhje me hyrjen e Kontraktorit në një Marrëveshje hidrokarbure, (siç përcaktohet në licencëmarrëveshjen) me Albpetrolin:

1. Për këtë këtu, Albpetroli transferon të gjitha të drejtat, privilegjet dhe detyrimet e tij sipas licencëmarrëveshjes së përmendur Kontraktorit, në përputhje me Marrëveshjen hidrokarbure të lartpërmendur; dhe

2. Albpetroli dhe Kontraktori bien dakord që ata së bashku dhe veçmas, do të jenë përgjegjës ndaj Ministrisë, sipas licencëmarrëveshjes së lartpërmendur, për të gjitha detyrat dhe detyrimet e të licencuarit, vetëm siç përcaktohet në mënyrë specifike në licencëmarrëveshjen e lartpërmendur.

3. Me ekzekutimin e këtij instrumenti transferimi, AKBN-ja konfirmon se ajo ka dhënë aprovimin paraprak me shkrim për këtë transferim, që Kontraktori ka dorëzuar në AKBN, dëshmi të arsyeshme të kompetencës së tyre financiare dhe/ose teknike dhe që AKBN-së i kërkohet që të mos refuzojë miratimin e saj në një mënyrë të paarsyeshme dhe të pandershme dhe që ata pranojnë që Albpetroli dhe Kontraktori janë palë në licencëmarrëveshjen e lartpërmendur si të licencuar.

4. Ky instrument transferimi kushtëzohet me hyrjen e Albpetrolit dhe Kontraktorit në Marrëveshjen hidrokarbure të lartpërmendur dhe aprovimin prej Këshillit të Ministrave të kësaj Marrëveshjeje hidrokarbure.

5. Në vijim të nënshkrimit të këtij instrumenti transferimi, interesat e Albpetrolit dhe Kontraktorit do të jenë siç përcaktohen në Marrëveshjen hidrokarbure në fjalë.

Me dëshmi për sa më sipër, palët nënshkruajnë këtë instrument transferimi ditën dhe vitin e shkruar në faqen e parë.

Firmosur nga

Me autorizim të rregullt, për dhe në emër të "Albpetrol"

Firmosur nga

Me autorizim të rregullt, për dhe në emër të Sherwood International Petroleum Ltd

Firmosur nga

Me autorizim të rregullt, për dhe në emër të "AKBN"-së

## ANEKSI F

### PROCEDURA E MARRJES NË DORËZIM

#### A. Procedura e përgjithshme e marrjes në dorëzim

Menjëherë pas datës efektive, Albpetroli dhe Kontraktori do të kryejnë një transferim të përgjegjësisë operacionale për zonën e projektit. Ky transferim përfshin, pa kufizim, transferimin dhe dorëzimin të Kontraktorit nga AKBN-ja, Albpetroli dhe çdo filial i tyre të aseteve, të drejtave, dokumenteve dhe materialeve të mëposhtme, që ndodhen në zonën e kontratës ose në zyrat e tyre respektive dhe të përdorura, ose të dobishme në lidhje me aktivitetet në zonën e projektit. Asetet, të drejtat, dokumentet dhe materialet do të jenë në mënyrë thelbësore të njëjta si ato të përshkruara në licencëmarrëveshjen dhe këtë Marrëveshje.

#### B. Procedura e marrjes në dorëzim të puseve

##### 1. Përgjegjësitë e Kontraktorit:

##### a) Njoftim i Kontraktorit:

i) Kontraktori do t'i dorëzojë Albpetrolit një listë paraprake të puseve, që synohen të merren në dorëzim për çdo tremujor kalendarik, brenda tridhjetë ditëve, nga fillimi i atij tremujori kalendarik. Kjo listë paraprake mund të rishikohet pas marrjes së informacionit të dosjeve të puseve dhe të jetë verifikuar gjendja e kezingjeve.

ii) Do të jepet njoftim dy javë para datës së kërkuar për marrje në dorëzim.

iii) Nëse Kontraktori zgjedh të kryejë punë verifikuese paraprake për kezingun, duke përdorur shërbimet dhe traktorët e remontit të Albpetrolit, marrja në dorëzim nuk është zyrtare, derisa Kontraktori ka lëshuar njoftim me shkrim, që i pranon kushtet e pusit për qëllime të llogaritjes së prodhimit të gjykuar të një pusi të veçantë, data efektive e marrjes në dorëzim e pusit do të jetë retrospektivisht me datën, në të cilën filloi puna paraprake verifikuese e kezingut. Nëse puna paraprake verifikuese e pusit kryhet dhe Kontraktori zgjedh që të mos ta marrë në dorëzim pusin, atëherë Kontraktori do ta kompensojë Albpetrolin për prodhimin e humbur gjatë periudhës që pusi ishte i mbyllur për punë verifikuese. Kompensimi do të jepet në natyrë, bazuar në prodhimin mesatar ditor gjatë 10 ditëve para mbylljes së pusit.

iv) Nëse Kontraktori zgjedh të shtojë puse të tjera, që nuk janë në listën paraprake për këtë tremujor kalendarik, Albpetroli nuk do të kundërshtojë në mënyrë të paarsyeshme ose të vonojë këtë aprovim, me kusht që, megjithatë, në qoftë se është e arsyeshme për të bërë kështu Albpetroli mund të mos i aprovoi puset shtesë të tillë deri në përfundim të tremujorit kalendarik.

b) Të dhënat e pusit dhe shërbimet për integritetin e trungut të pusit:

i) Kontraktori do të bëjë kërkesë për informacionin që kërkon ose me njoftim dorëzuar dy javë para tremujorit kalendarik, ose në ndonjë kohë tjetër.

ii) Kontraktori do t'i paraqesë Albpetrolit programin e kërkesave për verifikim të kezingjeve të puseve dhe shërbimeve që do t'i kërkojnë Albpetrolit për t'u kryer. Është synim i Kontraktorit që të marrë në dorëzim vetëm puse, të cilat nuk shfaqin probleme integriteti të rëndësishme të pjesës fundore të kezingut. Nëse një pus gjendet se ka probleme të tilla, Kontraktori do të riulë pajisjet, si në gjendjen para këtij shërbimi dhe me kosto të Kontraktorit dhe Kontraktori nuk do të ketë detyrime të mëtejshme në lidhje me një pus të tillë. Kontraktori merr përsipër përgjegjësitë për ndonjë pus, vetëm me marrjen përfundimtare të pusit (me kusht që sipas Marrëveshjes hidrokarbure, përgjegjësitë për kushtet para marrjes në dorëzim mbeten të Albpetrolit).

iii) Kontraktori mund t'i kërkojë Albpetrolit të kryejë shërbime me traktor, për të verifikuar integritetin e kezingut dhe punë të tjera të pastrimit të trungut, sipas programit të Kontraktorit. Kontraktori dhe Albpetroli do të bien dakord për një marrëveshje shërbimesh, duke përcaktuar kushtet dhe kostot për shërbimet e Albpetrolit me terma të njëjta me ato që ofrohen nga pala e tretë arm's length. Një kërkesë për shërbime (KPSH), së bashku me programin do të paraqitet nga Kontraktori, nëse ai do të kërkojë shërbime tek Albpetrolit.

c) Ndërtimi i shesheve

i) Kontraktori do të heqë kullat dhe pajisjet në vendin e përcaktuar nga Albpetroli, brenda zonës së kontratës, me kosto të Kontraktorit, kur pusi merret në dorëzim për operacione prodhimi dhe jo për situatën, kur ai është marrë në dorëzim, vetëm për suspendim të operacioneve të Albpetrolit, brenda sipërfaqes së rezervuarit ose për qëllime monitorimi.

ii) Kontraktori do të heqë ndotjen, të vendi i përcaktuar nga Albpetroli, për tokën e ndotur me kosto të Kontraktorit. Dëmtimet e mjedisit, për materialet e hequra, i mbeten Albpetrolit, si një kondicion ekzistues.

iii) Kontraktori, mund t'i kërkojë Albpetrolit largimin e tokës së ndotur, heqjen e kullës dhe pajisjeve dhe ndoshta ndërtimin e shesheve të reja të puseve. Kjo kërkesë do të bëhet nëpërmjet një kërkesë për shërbime "KPSH" dhe të kryhet në përputhje me një marrëveshje shërbimi.

iv) Kontraktori do të rindërtojë sheshe pusi në standardet e veta dhe sipas rregullave dhe lejes së mjedisit.

d) Marrja në dorëzim e puseve për monitorim:

i) Kontraktori mund të marrë në dorëzim puse, por jo vend në prodhim aktiv, për arsye të monitorimit të kushteve të rezervuarit dhe për nxjerrje optimale nga rezervuari dhe kërkesa rrjeti (distancë).

ii) Detyrimi për operacione të ardhshme në këto puse do të jetë i kufizuar në trungun e pusit dhe ndonjë fluid i çliruar nga këta. Kontraktorit nuk do t'i kërkojë të heq pajisjet e Albpetrolit nga këto sheshe puseve ose të largojë ndonjë ndotje. Nëse pajisjet do të kërkojnë nga Albpetroli, (me përjashtim të tubingut në fundin e pusit, i cili mund të kërkojë të mbetet në trung), Albpetroli është i titulluar t'i heq me kosto të tij dhe kushtet konkrete të tij. Gryka e pusit do të mbetet e siguruar dhe e mbyllur me çelës, kurse energjia në shesh e stakuar.

iii) I vetmi inventar i regjistruar për transferim do të lidhet me grykën e pusit dhe fundin e

pusit.

iv) Kontraktori do të ketë leje për të hyrë në këtë shesh.

e) Inventari:

i) Një ditë para marrjes në dorëzim zyrtarisht, përfaqësuesit e Kontraktorit do të takohen në sheshin e pusit, për të kryer një inventar të pajisjeve, që do të merren në dorëzim nga Kontraktori.

ii) Inventari do të përfshihet në formularin e marrjes në dorëzim, që do të firmoset si nga përfaqësuesit e Albpetrolit dhe të Kontraktorit. Kjo do të përfshijë përgjegjësitë për Albpetrolin dhe marrjes së shesheve të puseve nga Kontraktori, në këto kushte.

iii) Duhet vënë në dukje, që inventari i marrë në dorëzim, mund të mos disponohet në të ardhmen, për shkak të konsumimit dhe shkatërrimit prej operacioneve dhe Kontraktori nuk është përgjegjës në ndonjë mënyrë ta kthej në të tillë.

f) Paraekzistues:

i) Prodhimi paraekzistues do të llogaritet mbi bazën e formulës në Marrëveshjen hidrokarbure dhe bazuar në të dhënat e prodhimit të dhënë nga Albpetroli. Kontraktori ka të drejtën e shqyrtimit në detaje të këtyre të dhënave dhe metodat për llogaritjet e kaluara. Sapo të pranohet nga të dyja palët, ky prodhim do të shërbejë si bazë për llogaritje të prodhimit paraekzistues në të ardhmen.

2. Përgjegjësitë e Albpetrolit

a) Dorëzimi i sheshit dhe i pusit:

i) Albpetroli do të dorëzojë te Kontraktori brenda dy javësh pusin dhe sheshin.

b) Të dhënat e pusit:

i) Albpetroli do t'i japë, në datën 15 të çdo muaji pasardhës, të dhënat e prodhimit, (naftën neto, ujin, rërën dhe orët e prodhimit) për të gjitha puset brenda zonës së kontratës, që janë operuar nga Albpetroli.

ii) Albpetroli do t'i japë informacionet e dosjeve të puseve (ose kopje të orgjinalit) brenda një jave, prej kërkesës së Kontraktorit, si për një pus që merret në dorëzim, ose për qëllime të tjera.

c) Kushtet paraekzistuese:

i) Kushtet paraekzistuese do t'i mbeten përgjegjësi e Albpetrolit. Materialet e ndotura të hequra nga sheshi, para datës së marrjes në dorëzim, do të shkojnë në sheshin e grumbullimit dhe trajtimit të përcaktuar nga Albpetroli dhe mbeten detyrim i Albpetrolit.

ii) Sipas Marrëveshjes hidrokarbure, për secilin pus para marrjes në dorëzim, do të kryhet një studim i linjës bazë për të identifikuar kushtet paraekzistuese. Albpetroli do të bashkëpunojë me ndonjë studim të tillë. Nuk do të kryhen aktivitete të mëtejshme në këto sheshe, sapo të jetë përfunduar kjo dhe Kontraktori ka marrë në dorëzim pusin (pavarësisht për monitorim ose për prodhim).

iii) çdo aktivitet nga Albpetroli në sheshe të puseve të marra në dorëzim do të çojë në ndërprerje të menjëhershme nga Kontraktori të detyrimeve të prodhimit paraekzistues, të mëparshëm dhe të ardhshëm, që ka Kontraktori, dhe të gjitha detyrimet i kalojnë Albpetrolit, me përjashtim kur, Kontraktori pranon që Albpetroli t'i ndërpresë këto aktivitete dhe të ripranohen përgjegjësitë e marrjes në dorëzim.

d) Shërbimet në puse dhe ndërtimi i shesheve të puseve

i) Është synim i Kontraktorit të përdorë traktorë të Albpetrolit për shërbime të verifikimit të integritetit të kezingut të pusit, para marrjes në dorëzim. Albpetroli do të ofrojë, nëse do të jetë i disponueshëm, një traktor sonde për Kontraktorin, brenda periudhës së njoftimit dhe sipas marrëveshjes së shërbimit të rënë dakord.

ii) Vetëm për trungjet e puseve, të cilat janë marrë në dorëzim, (jo sheshet e puseve), nga Kontraktori, Albpetroli do t'i japi Kontraktorit leje të plotë. Albpetroli do të sigurojë që energjia elektrike në sheshet e puseve është shkëputur. Të gjitha pajisjet sipërfaqësore dhe kushtet e dhënies në përdorim të tokës, do të mbeten përgjegjësi e Albpetrolit. Çdo heqje e pajisjeve sipërfaqësore do të jetë me zgjedhje dhe kosto të Albpetrolit.

e) Inventari dhe lirimi

i) Një ditë para ditës së marrjes në dorëzim, përfaqësuesit e Kontraktorit do të takohen në vend për të bërë një inventar të pajisjeve, që do të merren në dorëzim nga Kontraktori.

ii) Inventari do të përfshihet në një formular marrjeje në dorëzim që do të lëshohet dhe firmoset si nga përfaqësuesit e Albpetrolit dhe ata të Kontraktorit. Kjo do të përfshijë detyrimin për prodhimin paraekzistues, (përveç përgjegjësi të mjedisit), për Albpetrolin dhe marrjes së sheshit të pusit nga Kontraktori në ato kushte.

iii) Duhet vënë në dukje që inventari i marrë në dorëzim mund të mos jetë i disponueshëm në të ardhmen, për shkak të prishjes dhe konsumimit normal të materialit të konsumueshëm dhe Kontraktori nuk është përgjegjës në asnjë mënyrë ta kthejë inventarin në kushtet në të cilën u dorëzua te Kontraktori.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)**  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

### BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

### *Së shpejti në treg:*

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 2.11.2007  
Doli nga shtypi më 2.11.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"  
Tiranë, 2007

Çmimi 44 lekë